

RAPORTI VJETOR PËR KRIMET NGA URREJTJA

NË VITIN
2017

**KRIMENGA
URREJTJA**



Përmbajtja e këtij publikimi nuk i përfaqëson gjithmonë këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup. Misioni i përmbahet Vendimit PC DEC/81 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së.

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë,
përfaqësuar nga Kryetari prof. dr. Gordan Kallajxhiev

Redaktor:

Uranija Pirovska

Autorë:

mr. Velimir Delovski
mr. Angela Saplieva



Naum Naumovski Borçe 83
1000, Shkup
Tel: +389 (0)2 3119 073
Faks: +389 (0)2 3290 469
Web: www.mhc.org.mk
E-mail: helkom@mhc.org.mk

PËRMBAJTJA

1. PËR PROJEKTIN	66
2. METODOLOGJIA	67
2.1 Monitorimi i mediave nacionale të shtypura dhe mediave elektronike	67
2.2 Raportimi në Misionin e OSBE-së në Shkup mbi incidentet dhe krimet nga urrejtja	67
2.3 Mirëmbajtja e ueb-faqes interaktive për paraqitjen e krimeve nga urrejtja	67
3. REZYME E GJETJEVE KRYESORE	68
3.1 Konteksti	68
3.2 Numri i incidenteve	68
3.3 Lloje të veprave penale	71
3.4 Incidentet sipas vendndodhjes	71
3.5 Incidentet sipas muajve	72
3.6 Incidentet sipas motivimit të njëanshëm	73
3.7 Viktimat dhe kryerësit	73
3.8. Statusi i rasteve	73
4. AKTIVITETET E EKIPIT TË PROJEKTIT	75
4.1 Ndjekja e mediave nacionale elektronike dhe të shtypura	75
4.2 Rishqyrtimi i krimeve të paraqitura nga urrejtja dhe kontributi i Raportit vjetor të OSBE/ODIHR-it për krimet nga urrejtja dhe incidentet në rajonin e OSBE-së	75
4.3 Mirëmbajtja, përditësimi dhe përkthimi i ueb-faqes www.zlostorstvaodomraza.mk	75
4.4 Përgatitja e informatorëve mujorë mbi gjetjen e krimeve nga urrejtja në shtet	76
4.5 Përgatitja, përkthimi dhe shpallja e raportit të ndjekjes së krimeve nga urrejtja për vitin 2017	76
4.6 Shënimi i ditës së propozuar si Dita evropiane për viktimat nga veprat e urrejtjes (22 korrik) nëpërmjet organizimit të konferencës për shtyp dhe evenimentit “Turlitavë”	76
4.7 Shkëmbimi i gjetjeve nga Raporti i monitorimit për vitin 2016 me institucionet të cilat mund të kishin interes për to	76
4.8 Organizimi i konferencës për shtyp për të shpërndarë gjetjet e Raportit vjetor	76
4.9 Përfshirja e informacioneve për krimet nga urrejtja në raportet mujore të KMH-së në aspektin e situatës me të drejtat e njeriut në vend	77
5. PËRFUNDIME	77
6. REKOMANDIME	78
ANEKSI	79
Incidente të krimeve nga urrejtja për vitin 2017	79

1. PËR PROJEKTIN

Ky raport është rezultat i projektit “Parandalimi i diskriminimit dhe ballafaqime me krimin nga urrejtja dhe gjuhën e urrejtjes”, që është mbështetur financiarisht nga Misioni i OSBE-së në Shkup, kurse është zbatuar në periudhën midis 1 janarit dhe 31 dhjetorit 2017. Projekti kishte si qëllim të merret me çështjen e veprave nga urrejtja dhe nga gjuha e urrejtjes nëpërmjet legjislacionit të përparuar, ngritjen e vetëdijes publike, ndërtimit të kapaciteteve të agjencive të drejtësisë penale dhe regjistrimin e incidenteve të shkaktuara nga paragjykimi. Më konkretisht, ky raport duhet të shërbejë si indikator mbi spektrin, natyrën dhe shpeshtësinë e veprave penale nga urrejtja të kryera në shtet.

Në suazat e mandatit të vet të partneritetit zbatues në këtë projekt, KMH i ka zbatuar këto aktivitete në lidhje me krimet nga urrejtja:

1. Ndjekja e mëtejshme e incidenteve/krimeve nga urrejtja me kujdes të veçantë mbi dhunën në sport, që është motivuar nga anësia;
2. Rishqyrtimi i krimeve të paraqitura nga urrejtja dhe kontributi në Raportin vjetor të ODHIR për krime nga urrejtja dhe incidente në rajonin e OSBE-së;
3. Mirëmbajtja, përditësimi dhe përkthimi i ueb-faqes www.zlostorstvaodomraza.mk;
4. Përgatitja e informatorëve mujorë mbi gjendjen me krimet nga urrejtja në vend;
5. Përgatitja, përkthimi dhe botimi i raportit mbi ndjekjen e krimeve nga urrejtja për vitin 2017 në maqedonisht, shqip dhe anglisht;
6. Shënimi i ditës së propozuar si Dita e viktimave nga urrejtja (22 korrik) nëpërmjet organizimit të konferencës për shtyp dhe evenimentit “Turlitava”;
7. Zbatimi i gjetjeve nga Raportit monitorues për vitin 2016 me institucionet të cilat do të kishin interes për këtë punë;
8. Organizimi i konferencës për shtyp që të tregohen gjetjet e raportit vjetor; dhe
9. Përfshirja e informacioneve mbi krimet nga urrejtja në raportet mujore të KMH-së në aspektin e situatës me të drejtat e njeriut në vend.

2. METODOLOGJIA

2.1 Monitorimi i mediave nacionale të shtypura dhe mediave elektronike

KMH-ja ka monitoruar shumë gazeta ditore me tendencë ideologjike dhe me përkatësi politike të ndryshme. Monitorimi i mediave elektronike është bërë në bazë ditore, nëpërmjet dy gjeneratorëve më të famshëm të lajmeve në internet (www.time.mk dhe www.grid.mk), si dhe nëpërmjet përdorimit të opsioneve për kërkim të përparuar në rubrikën “Lajme” në www.google.com. Me t'u vërejtur vepra apo incidenti nga urrejtja, KMH-ja e regjistron titullin e lajmit dhe lidhjen në internet, dhe më pas e shpallte atë në portalin në internet për paraqitjen e veprave nga urrejtja www.zlostorstvpodomraza.mk (shiko aktivitetin 2.3 më poshtë). Si rezultat i zbatimit të këtij aktiviteti në periudhën midis 1 janarit dhe 31 dhjetorit të vitit 2017 KMH-ja arriti të regjistrojë dhe shpallët 70 vepra/incidente nga urrejtja.

2.2 Raportimi në Misionin e OSBE-së në Shkup mbi incidentet dhe krimet nga urrejtja

Detajet në lidhje me incidentet (përshkrimi i shkurtër, koha dhe vendi, burimi i informacioneve, viktimat e përfshira, kryerësit, statusi i rastit, përgjigja e organeve kompetente, ndikimi mbi viktimat dhe mbi bashkësinë) janë dërguar te Misioni i OSBE-së në Shkup, kurse për shpalljen e tyre më të lehtë kontribuoi mjaft funksionimi i mëtejshëm me sukses i ueb-platformës për krime nga urrejtja. Përveç se incidentet e krimeve nga urrejtja mund të ndiqeshin në internet, pasi të kenë ndodhur, Misioni i OSBE-së në Shkup ka marrë edhe një raport të përkohshëm dhe një raport përfundimtar, të përgatitur nga KMH-ja. Ky raport përfundimtar do të shkëmbehet me OSBE/ODIHR-in për raportin e tyre vjetor mbi krimet nga urrejtja në shtetet pjesëmarrëse në OSBE.

2.3 Mirëmbajtja e ueb-faqes interaktive për paraqitjen e krimeve nga urrejtja


Ueb-portali www.zlostorstvaodomraza.com (që nga viti 2014, gjendet gjithashtu edhe në këtë adresë www.zlostorstvaodomraza.mk) është një mjet interaktiv i cili u mundëson qytetarëve të marrin informacione dhe të paraqesin vepra nga urrejtja. Ai përmban hartë interaktive e cila e tregon lokacionin e saktë apo të përafërt të incidenteve. Në faqen kryesore janë vendosur kategoritë e veprave nga urrejtja dhe motivimet e anshme, ai siguron informacione mbi mënyrën se si qytetarët mund të bëjnë paraqitje (e-aplikacione, Tuiet, postë elektronike dhe formular elektronik), dhe në të janë treguar grafikë statistikore. Gjithashtu ka edhe rubrika kushtuar pyetjeve të parashtruara më shpesh, materiale, fjalorth të ueb-portalit, në suazat e të cilave mund të gjenden informacione në aspektin e projektit, mbi rëndësinë dhe spektrin e veprave nga urrejtja, si dhe publikime për krimet nga urrejtja. Përveç se në maqedonisht, kjo faqe është edhe mirëmbahet dhe përditësohet rregullisht edhe në anglisht dhe shqip.

3. REZYME E

GJETJEVE KRYESORE

3.1 Konteksti

Raportet e përparimit të Komisionit Evropian të shpallura në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2016 për shtetin thonë se “Nuk ka në dispozicion mbledhje të të dhënave sistematike mbi informimin, hetimin dhe ndjekjen e gjuhës së urrejtjes dhe veprave nga urrejtja, të dhënat e mbledhura dëshmojnë se veprat e tilla penale nuk ndiqen në mënyrë adekuate në pushteti dhe është e domosdoshme të sigurohen trajnime për mbartësit e zbatimit të ligjeve, prokurorët publikë dhe gjykatësit”. Analiza e veçantë e veprave nga urrejtja të regjistruara në 2013, raportet vjetore për krimet nga urrejtja në vend për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ky raport dhe ueb-portali për paraqitjen e veprave nga urrejtja, www.zlostorstvaodomraza.mk, përfaqësojnë përpjekjet e para dhe gjithëpërfshirëse që të hartohen, monitorohen dhe paraqiten incidentet e veprave nga urrejtja në vend.



3.2 Numri i incidenteve

Në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2017, Komiteti i Helsinkit ka regjistruar gjithsej 70 incidente dhe vepra nga urrejtja. Incidentet janë regjistruar menjëherë pasi ato janë paraqitur nga mediat apo Ministria e Punëve të Brendshme. Nga numri i përgjithshëm i veprave/incidenteve të regjistruara, 58 incidente janë vërtetuar, kurse 12 incidente mbeten të pavërtetuar.

Shumica e incidenteve janë vërtetuar në kontakt me policinë, buletinet policore dhe informimet në media. Incidentet e pavërtetuara janë përfshirë në këtë raport duke pasur parasysh se ekzistojnë indikatorë të anësisë, duke përfshirë: perceptimin e viktimës/dëshmitarit; komenteve të dhëna në vendngjarje; dallimit midis viktimës dhe kryerësit në bazë etnike; shembulli/shpeshësia e incidenteve të mëparshme; natyra e dhunës; mungesa e motiveve të tjera; dhe vendi dhe koha. Më saktësisht, incidentet e pavërtetuar janë përfshirë për shkak të informacioneve të marra në aspektin e vendit të incidentit (për shembull, fqinjësi dhe shkolla me përbërje etnike të përzierë, linja autobusësh të cilat i përdorin përfaqësuesit e bashkësive të ndryshme etnike, vende ku vepra nga urrejtja ka ndodhur më përpara në të kaluarën etj.), llojit të incidentit (për shembull, një grup më i madh të miturish sulmon një apo më tepër viktimë pa qenë të provokuar, rrahje në grup, sulm në autobus apo në stacion autobusi etj.), koha e incidentit (pas një rrahjeje paraprake si formë hakmarrjeje, në orët e mësimin, gjatë apo në një eveniment sportiv etj.) dhe pronës së dëmtuar gjatë incidentit (për shembull, vende për mbajtjen e ritualeve fetare).

Incidentet e pavërtetuara dhe të vërtetuara mund të shihen më vete në ueb-portalin për paraqitjen e veprave nga urrejtja (ato të vërtetuarat janë shënuar me një kopsë tekstuale të gjelbër,

kurse të pavërtetuarat me një kopsë tekstuale të kuqe). Në Aneksin e dhënë në këtë raport vjetor, pas titujve të incidenteve statusi i vërtetuar/pavërtetuar është vendosur në kllapa.

Përkatësia politike (35 incidente) dhe kombësia (30 incidente) përbën shumicën e bazave mbi të cilat janë kryer veprat nga urrejtja në vitin 2017. Mandej, 2 incidente kanë ndodhur në bazë të bindjeve fetare, 2 incidente për shkak të diskriminimit racor, 2 incidente për shkak të statusit të viktimës si refugjat apo migrant dhe 2 incidente janë regjistruar pas mbajtjes së një evenimenti sportiv. 3 incidente i plotësojnë kriteret për veprën penale “Shkaktim i urrejtjes nacionale, racore apo fetare, përçarje apo mostolerancë”. Viktimat dhe kryerësit më shpesh janë të rinjtë dhe anëtarët e përkatësive të ndryshme etnike (kryesisht maqedonas dhe shqiptarë). Shpesh, veprat penale të kryera si një incident i plotësojnë kriteret për dy apo më tepër vepra penale, prandaj ekzistojnë një numër i madh veprash penale në lidhje me incidentet. Shumica e incidenteve të shkaktuara për shkak të përkatësisë politike apo bindjeve politike nuk përfshijnë njerëz si viktimë. Si viktimë, në këto raste janë personat juridikë, kurse kjo është kështu sepse shumica e këtyre incidenteve kanë të bëjnë me dëmtimin e pronës dhe shkaktimin e dëmtimit material.

Shumica e veprave penale të dhëna përfshijë : dhunë 934), dëmtim të pronës (30) dhe lëndim trupor dhe lëndim të rëndë trupor (30). Mandej, 5 incidente futen në grupin e shkaktimit të urrejtjes dhe mostolerancës në bazë diskriminuese nacionale, racore, fetare apo tjetër, 5 në rrezikimin e sigurisë dhe 4 incidente në grupin e kërcënimit me armë të rrezikshme gjatë rrahjes apo zënkës.

Detaje në aspektin e incidenteve, siç janë: përshkrimi i shkurtër, data, koha, vendi, burimi i informacioneve, viktimat e involvuara, kryerësit statusi i rastit, përgjigja nga pushteti, dhe ndikimi mbi viktimën/viktimat dhe mbi bashkësinë mund të gjenden në Aneksin e titulluar “Incidente të krimeve nga urrejtja në 2017” në këtë raport. Në këtë aneks ka edhe një fushë për “indikatore të anësisë”, që është vendosur në çdo incident. Kjo përfshin të dhëna për: perceptimin e viktimës/dëshmitarit, komentet e bëra në vendngjarje; dallime midis viktimës dhe kryerësit në baza etnike; shembullin/shpeshësinë e incidenteve të mëparshme; natyrën e dhunës; mungesën e motiveve; dhe kohën e vendin. Përveç sigurimit të informacioneve shtesë në aspektin e incidenteve, kjo pjesë është mjaft e rëndësishme që të kuptohet pse incidentet e pavërtetuara janë përfshirë, gjithashtu, në këtë raport.

Në prill të vitit 2017 KMH-ja ia ka dërguar Raportin vjetor për veprat nga urrejtja për 2017 OSBE/ODHIR-it.¹ KMH-ja mbetet e vetmja organizatë joqeveritare relevante e cila e informon OSBE/ODIHR-in mbi situatën me veprat e urrejtjes në vend.

Numri i incidenteve të regjistruar në vitin 2017 është identik me numrin e incidenteve në vitin 2016. Megjithatë, ekzistojnë dallime të theksuar në aspektin e motivimit të anshëm në bazë të së cilës janë kryer veprat nga urrejtja.

Ndryshimi më i madh lidhet me numrin e veprave nga urrejtja të kryera për shkak të përkatësisë apo bindjes politike. Kurse në vitin 2016 30% e të gjitha incidenteve ishin kryer në bazë të përkatësisë apo bindjes politike të viktimave/kryerësve (21 nga 70), në 2017 këto incidente kanë pasur një rritje zëmadhe dhe numri i tyre ka arritur në 50% (35 nga 70) të të gjitha incidenteve të regjistruara. Rritja e këtyre llojeve të veprave nga urrejtja është e evident para dhe pas periudhës së zgjedhjeve. Këto lloje incidentesh ishin në rritje para dhe pas zgjedhjeve parlamentare në vitin 2014, zgjedhjeve presidenciale në të njëjtin vit dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2016. 26 nga 35

1) <http://hatecrime.osce.org/former-yugoslav-republic-macedonia>


incidentet e paraqitura me këtë bazë kanë të bëjnë me thyerjen, demolimën apo ndonjë lloj tjetër shkatërrimi përkatësisht dëmtim i shtabeve, përkatësisht pronës së partive politike.

Këtë vit incidentet e llojeve të përmendura më sipër intensivohen sidomos pasi partia politike VMRO DPMNE nuk arriti të sigurojë shumicën prej minimum 61 deputetësh në suazat e kufizimit kohor me Kushtetutë dhe gjatë negociatave për formimin e qeverisë. Në vijimin e mëtejshëm të viti, numri i veprave nga urrejtja të që janë kryer në bazë të përkatësisë politike apo bindjes politike është rritur përsëri gjatë fushatës parazgjedhore për zgjedhjet lokale. Kjo dëshmon lidhje të drejtpërdrejtë shkakore-pësore midis gjuhës së urrejtjes dhe që përdoret gjerë gjatë fushatave parazgjedhore dhe veprave nga urrejtja që janë kryer në atë periudhë.

Dallimi i dytë i rëndësishëm është i dukshëm në aspektin e numrit të incidenteve të shkaktuar në bazë të përkatësisë etnike, maqedonase apo shqiptare, të viktimave/ushtuesve. Në vitin 2013 këto incidente përfshinin një vlerë prej 84% të të gjitha incidenteve (98 nga 116), kurse në vitin 2014 kjo vlerë ishte 61% (53 nga 87). Në vitin kanë ndodhur vetëm 34% incidente të tilla (15 nga 44), kurse gjatë vitit 2016, 34 incidente (pothuajse 50%) kanë ndodhur midis maqedonasve dhe shqiptarëve. Në vitin 2017 ka pasur një ulje të vogël në numrin e incidenteve ku janë përfshirë përfaqësues të bashkësisë etnike maqedonase dhe shqiptare (43% e të gjitha incidenteve të regjistruara). Megjithatë kjo nuk dëshmon një trend të zvogëlimit të theksueshëm dhe këto incidente mbeten problemi më shqetësues, sidomos në aspektin se shumica e viktimave dhe kryerësve të këtyre incidenteve janë të mitur.


Njëjtë si në vitin 2015 dhe 2016, në vitin 2017 nuk është regjistruar asnjë incident nga urrejtja në bazë të identitetit gjinor/orientimit seksual të viktimës. Ky fakt nuk do të thotë se shoqëria është bërë më tolerante në lidhje me bashkësinë LGBT. Në këtë rast duhet të përmendim se pushtetet vendase nuk kanë arritur t'i hetojnë incidentet në vitin 2013/2014, dhe asnjë kryerës nuk është arrestuar nga policia. Lëshimi i shtetit që të veprojë në mbrojtje të viktimave, refuzimi i Kuvendit që ta përfshijë orientimin seksual si bazë e cila mund të shkaktojë diskriminim dhe vepra nga urrejtja, dhe planet e Qeverisë së kaluar që ta përcaktojë martesën vetëm si bashkësi midis një burri dhe një gruaje në vitin 2013, patën efekt negativ mbi njerëzit LGBT të cilët mund të kishin frikë që t'i paraqisnin veprat kundër tyre. Megjithatë, në vitin 2017, Qeveria e re i ndërmoi hapat e para në drejtim të zmadhimit të mbrojtjes së të drejtave të bashkësisë LGBT. Fundjava e krenarisë që u mbajt në Shkup në qershor 2017 është hapur zyrtarisht nga ministri i kulturës i cili foli mbi gatishmërinë e Qeverisë që të punojë në përmirësimin e trajtimit të bashkësisë LGBT. Ai tha se politikat kulturore të cilat janë bazuar kryesisht në konceptet e vjetërsuara kulturore duhet të zëvendësohen me strategji të cilat i marrin parasysh shumëllojshmërinë dhe heterogjenitetin e kulturave të ndryshme dhe praktikave kulturore, që nga ana tjetër i pasqyrojnë nevojat, specifikat, ankesa, interesat dhe bindjet e grupeve të ndryshme në shoqëri. Gjithashtu, për herë të parë në historinë e shteti, kryeministri, Zoran Zaevi ka marrë pjesë në 5-vjetorin e Qendrës LGBT për mbështetje që është filial i KMH-së. Me këtë ai haptas dha mbështetje për bashkësinë LGBT dhe e theksoi përkushtimin e Qeverisë që ta harmonizojë legjislacionin vendas me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nëpërmjet përgatitjes së ligjit të ri për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Njëkohësisht, ai informoi se sulmet e pazgjidhura mbi njerëzit LGBT dhe Qendrën LGBT do të hetohen si duhet dhe sulmuesit do të nxirren para drejtësisë.

3.3 Lloje të veprave penale




Shumica e incidenteve janë kryer nga të rinj. Gjithashtu, ekziston një numër i madh kryerësish të panjohur. Viktimat dhe kryerësit janë zakonisht përfaqësues të bashkësive etnike të ndryshme (maqedonase dhe shqiptare). Incidentet e regjistruara lidhen me disa vepra penale që janë përcaktuar në Kodin Penal. Pjesa më e madhe e veprave penale përfshin: dhunë (34), dëmtim të pronës së huaj (30) dhe lëndim të rëndë trupor (30). Mandej, 5 incidente futen në grupin e shkakimit të urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës në bazë diskriminuese racore, nacionale, fetare apo bazë tjetër dhe 5 futen në rrezikimin e sigurisë, 4 incidente në kërcënim me armë të rrezikshme gjatë grindjes dhe rrahjes. Shpesh veprat penale të kryera në një incident i plotësonin kriteret për dy apo më tepër incidente të paraqitura në këtë kapitull.

3.4 Incidentet sipas vendndodhjes



51 incidente (73%) kanë ndodhur në Shkup dhe në rajonin e tij më të gjerë qytetar. Katër incidente janë regjistruar në Manastir, 3 në Prilep, 2 në Kavadar, Sveti Nikollë, Ohër, Kërçovë dhe Kumanovë dhe 1 incident në Shtip dhe Veles (vendndodhje e bazuar në rajonin më të gjerë të këtyre qyteteve).




3.6 Incidentet sipas motivimit të njëanshëm

Veprat nga urrejtja që kanë ndodhur për shkak të përkatësisë politike përfshijnë 50%, përkatësia etnike 43%, raca 4% dhe përkatësia apo bindja fetare 3%. Shumica e incidenteve përfshijnë maqedonas dhe shqiptarë etnikë dhe si viktime dhe si kryerës.

3.7 Viktimat dhe kryerësit


Gjatë vitit kishte minimum 60 viktime dhe 225 kryerës të veprave nga urrejtja. Gjithmonë kur mediat informonin për një numër të papërcaktuar (për shembull, midis 10 dhe 15) kryerësish, për qëllimet e këtij raporti është përdorur vlera më e vogël. Gjithmonë kur informonin se një “grup” kryerësish e kanë kryer veprën nga urrejtja, vlera e përdorur në këtë raport është 3 persona. Në minimum 31 nga 70 incidente kryerësit kanë vepruar si grup. Shumica e viktimave kanë qenë të rinj. Minimum 24 viktime ishin të mitur.



3.8. Statusi i rasteve

Duke pasur parasysh se nuk ekziston bazë të dhënash për krime nga urrejtja, rastet janë regjistruar në komunikim me policinë, ndjekjen e mediave dhe informacionet e marra drejtpërdrejt nga viktimat.

Për çdo incident të regjistruar, KMH-ja i ka dërguar kërkesë për informacione Ministrisë së Punëve të Brendshme që të marrë informacion mbi statusin e rasteve. Deri në përfundim të këtij raporti, MPB-ja siguroi informacione për 63 nga gjithsej 70 incidentet e regjistruara. Vetëm për 3 incidente nuk është dorëzuar asnjë përgjigje. Mandej, përgjigja e marrë nga Ministria në lidhje me 4 incidente të tjera nuk ka qenë e tërësishme dhe nuk ka pasur asnjë informacion korrekt në lidhje me statusin e incidentit, sepse në të vetëm është konstatuar se ngjarja e dhënë nuk është e evidentuar, përkatësisht nuk është regjistruar në evidencën e MPB-së.



Nga informacionet e marra del se në 3 raste personat kanë refuzuar të plotësojnë raport për pranim të paraqitjes së incidentit, kështu që ato janë mbyllur nga policia për shkak të konstatimit se nuk ekziston çfarëdolloj ngjarjeje penale-juridike

dhe kundërvajtëse. Policia ka detektuar kryerësit e dyshuar lidhur me minimum 15 incidente nga 70 gjithsej, Nën hetim janë minimum 19 incidente, kurse statusi i 36 incidenteve mbetet i panjohur, nuk ekzistojnë informacione të mjaftueshme nga policia. Fletëparaqitje penale janë ngritur kundër 24 kryerësve vetëm në 8 prej rasteve të regjistruara, kurse në një ngjarje ka pasur ngritje të fletëparaqitjes kundërvajtëse për një person.

Nga 35 incidente gjithsej ku motiv i anshëm ka qenë përkatësia politike, përkatësisht bindja politike, vetëm për 2 është ngritur fletëparaqitje penale, kurse për 1 fletëparaqitje kundërvajtëse. Nga këto incidente 9 janë ende nën hetim, 2 incidente nuk janë evidentuar aspak, përkatësisht nuk janë regjistruar nga MPB edhe pse janë përcaktuar në mënyrë tjetër, kurse në një rast nuk është përcaktuar ekzistim i çfarëdo lloj ngjarjeje penale-juridike apo kundërvajtëse. Megjithatë, statusi i numrit më të madh të incidenteve, përkatësisht të gjitha incidentet e tjera mbeten të panjohura. Këto incidente përfshijnë viktimat të cilat janë anëtarë apo mbështetës të partive politike, duke përfshirë edhe kandidatë në zgjedhjet lokale në tetor 2017.

4. AKTIVITETET E EKIPIT TË PROJEKTIT

4.1 Ndjekja e mediave nacionale elektronike dhe të shtypura

KMH-ja ka ndjekur një numër të madh gazetash ditore me bindje ideologjike dhe përkatësi politike të ndryshme. Ndjekja e mediave elektronike bëhej përditë, nëpërmjet gjeneratorëve më të njohur të lajmeve në internet (www.time.mk dhe www.daily.mk), si dhe me përdorimin e opsioneve të përparuara për kërkim në seksionin "Lajme" www.google.com. Me t'u vërejtur vepra apo incidenti nga urrejtja, KMH-ja e shpallte atë në portalin në internet për paraqitjen e veprave nga urrejtja - www.zlostorstvpodomraza.mk (shiko aktivitetin 4.3 më poshtë). Duke e zbatuar këtë aktivitet KMH-ja arriti të regjistrojë dhe shpallët 70 vepra/incidente nga urrejtja në periudhën midis 1 janarit dhe 31 dhjetorit të vitit 2017.

4.2 Rishqyrtimi i krimeve të paraqitura nga urrejtja dhe kontributi i Raportit vjetor të OSBE/ODIHR-it për krimet nga urrejtja dhe incidentet në rajonin e OSBE-së

Në prill të vitit 2017 Komiteti i Helsinkit ia dërgoi Raportin e tij vjetor për vepra nga urrejtja për vitin 2017 OSBE/ODIHR-it.² Komiteti i Helsinkit mbetet organizata e vetme joqeveritare e cila informon OSBE/ODIHR-in mbi situatën me veprat nga urrejtja në vend.

4.3 Mirëmbajtja, përditësimi dhe përkthimi i ueb-faqes www.zlostorstvaodomraza.mk

Gjatë periudhës së raportit në këtë portal janë vendosur 70 incidente, 37 fotografi dhe 7 video. Raporti Vjetor për veprat nga urrejtja në vitin 2016 është shpallur në maqedonisht, shqip dhe anglisht, nën fushën "Materiale". Të gjitha incidentet e regjistruara në vitin 2017 do të përkthehen në shqip dhe anglisht dhe do të jenë në dispozicion në portal në këto gjuhë.

Midis 1 janarit dhe 31 dhjetorit 2017 portali është vizituar nga më tepër se 8.649 vizitorë të veçantë të cilët gjeneruan 19.630 shikime të faqes. Përveç portalit edhe grupi në Fejsbuk si dhe profili në Twitter janë azhurnuar rregullisht. Numri i ndjekësve në Fejsbuk në vitin 2017 ka qenë 4706, kurs në vitin 2016 ka qenë 3668. Njëkohësisht, portali është promovuar edhe nëpërmjet shpalljeve të sponsoruara në Fejsbuk duke e zmadhuar kështu numrin e vizitorëve në ueb-faqe. Për krahasim, tabela më poshtë e tregon numrin e vizitorëve për periudhën 2013-2017:

Viti	2013	2014	2015	2016	2017
Vizitorë	1,752	11,971	13,694	6,541	8,649

2) <http://hatecrime.osce.org/former-yugoslav-republic-macedonia>

4.4 Përgatitja e informatorëve mujorë mbi gjetjen e krimeve nga urrejtja në shtet

Gjatë periudhës së projektit të raportit KMH-ja përgatiti dhe shpalli shtatë informatorë mujorë. Në këtë mënyrë, nëpërmjet prezantimit grafik të të dhënave, publikut i janë prezantuar informacione mbi situatën me krimet nga urrejtja në vend. Buletinet mujore për muajin mars, qershor, korrik, shtator, tetor dhe nëntor janë shpallur në ueb-faqen e KMH-së,³ si edhe në faqen e Fejsbukut Zlostorstva od omraza.⁴ Duke pasur parasysh se nuk ka pasur incidente në prill, maj dhe gusht për këta muaj nuk janë shpallur informatorë.

4.5 Përgatitja, përkthimi dhe shpallja e raportit të ndjekjes së krimeve nga urrejtja për vitin 2017

Ky është një aktivitet i vazhdueshëm, i cili kompletohej me mbledhjen e përgjigjeve sipas kërkesave të dorëzuara për informacione te Ministria e Punëve të Brendshme.

4.6 Shënimi i ditës së propozuar si Dita evropiane për viktimat nga veprat e urrejtjes (22 korrik) nëpërmjet organizimit të konferencës për shtyp dhe evenimentit “Turlitavë”

KMH-ja e shënoi 22 korrikun, Ditën evropiane për viktimat nga veprat e urrejtjes nëpërmjet organizimit të dy evenimenteve të veçanta. Evenimenti i parë ishte konferencë për shtyp për mediat, kurse evenimenti i dytë ishte organizuar në Parkun e Qytetit në Shkup. Konferenca për shtyp ishte organizuar në hapësirat e KMH-së dhe gjatë kësaj është prezantuar Raporti vjetor për krimet nga urrejtja për vitin 2016. Ngjarja e dytë, pikniku me titull “Turlitava 4” është organizuar për herë të katërt me qëllim që të festohet toleranca dhe bashkëjetesa paqësore midis përfaqësuesve të bashkësive të ndryshme në vend. Evenimente përfshiu provim të ushqimit nga kuzhina tradicionale maqedonase, shqiptare, turke, serbe, kroate dhe boshnjake, si dhe muzikë dhe socializim midis pjesëmarrësve me prejardhje të ndryshme etnike. Evenimenti e theksoi rëndësinë e trajtimit të barabartë të grupeve të ndryshme në shoqëri dhe domosdoshmërinë për bashkëjetesë midis tyre. Mediat morën pjesë në të dyja evenimentet dhe shpallën 12 tekste në maqedonisht dhe 9 tekste në shqip për këto evenimente.

4.7 Shkëmbimi i gjetjeve nga Raporti i monitorimit për vitin 2016 me institucionet të cilat mund të kishin interes për to

Versioni elektronik mbi krimin nga urrejtja për vitin 2016 u është shpërndarë mbi 50 institucioneve dhe organizatave. Në gusht të vitit 2017, raporti u është dërguar, gjithashtu, këtyre institucioneve dhe organizatave në kopje të shtypur.

4.8 Organizimi i konferencës për shtyp për të shpërndarë gjetjet e Raportit vjetor

Ftesa për konferencën për shtyp është shpërndarë edhe në ueb-faqe dhe në faqen në Fejsbuk të KMH-së.

3) <http://www.mhc.org.mk/pages/reports>

4) <https://www.facebook.com/zlostorstvaodomraza>

4.9. Вклучување информации за злосторствата од омраза во месечните извештаи на МХК во поглед на ситуацијата со човековите права во земјата

Посебна рубрика за злосторствата од омраза беше вклучена во рамките на месечните извештаи во поглед на ситуацијата со човековите права во февруари, март, април, септември и октомври 2017 година, кога беа пријавени и најголемиот број инциденти.

5. PËRFUNDIME

- Numri i incidenteve të regjistruara në vitin 2017 është identik me numrin e incidenteve në vitin 2016;
- Është zmadhuar numri i incidenteve të kryera në bazë të përkatësisë apo bindjes politike dhe numri i incidenteve të tilla arrin vlerën alarmues prej 50% të incidenteve të regjistruara;
- Partitë politike e përdorin shpesh gjuhën e urrejtjes gjatë debateve publike dhe fushatave zgjedhor që si pasojë vijnë kryerjet e veprave nga urrejtja nga mbështetësit e tyre. Gjuha e urrejtjes është përdorur, gjithashtu, shumë në rubrikat për komente në mediat elektronike që gjenerojnë lajme politike;
- Ekziston një ulje e lehtë në numrin e incidenteve midis përfaqësuesve të bashkësisë etnike maqedonase dhe shqiptare, por ato mbeten më shqetësueset sepse numri më i madh i viktimave dhe kryerësve në ato incidente janë të mitur/të rinj;
- Qeveria i ndërmori hapat e parë mbi zmadhimin e mbrojtjes së të drejtave të bashkësisë LGBT;
- Është e paqartë ende se a e dinë pushtetet dallimin midis veprave nga urrejtja dhe gjuha e urrejtjes;
- Disa nga veprat e urrejtjes kryen për hakmarrje për shkak të një incidenti të mëparshëm midis rinisë maqedonase dhe shqiptare;
- Veprat e motivuar nga anësia nuk paraqiten dhe nuk janë hetuar si duhet nga policia;
- Janë bërë shumë pak përpjekje për masa parandaluese duke përfshirë edhe edukimin mbi të drejtat e njeriut dhe ngritjen e vetëdijes në publik;
- Meqenëse fenomeni i veprave nga urrejtja nuk trajtohet si çështje e ndarë, shteti nuk ofron mbrojtje dhe mbështetje të veçantë për viktimat; dhe
- Shumica e viktimave janë të mitur.

6. REKOMANDIME

1. Të merret parasysh përvoja e shteteve anëtare të BE-së në zgjerimin e kufijve në legjislacionin e tyre penal në spektrin/madhësinë e veprave penale të dënueshme nga urrejtja dhe përfshirjen e motiveve të tjera të anësisë që qëndrojnë pas këtyre veprave.
2. Të sigurohet hetim dhe ndjekje e shpejtë, azhurne dhe efektive e veprave nga urrejtja duke garantuar se motivet e anshme janë marrë parasysh edhe gjatë procedurës penale.
3. Të merren masat përkatëse që të ndihmohet paraqitja e veprave nga urrejtja nga viktimat, duke përfshirë masa për ndërtimin e besimit te policia dhe institucionet e tjera shtetërore.
4. Të mblidhen dhe shpallen sa më shumë të dhëna gjithëpërfshirëse dhe kompakte për veprat nga urrejtja duke përfshirë edhe numrin e incidenteve të tilla të paraqitura nga opinioni dhe të evidentuara nga organet e zbatimit të ligjit; numri i vendimeve; motivet anësore për këto vepra penale; dhe dënimet e shqiptuara për kryerësit.
5. Të sigurohet se viktimat e veprave nga urrejtja mbështeten dhe mbrohen.
6. Të përparohet trajnimi i praktikuesve relevantë që vijnë në kontakt me viktimat e veprave nga urrejtja që t'i ndihmojnë në mënyrë efikase këto viktima.
7. Të përforcohen masat parandaluese, midis të tjerash edhe nëpërmjet reflektimit të edukimit mbi të drejtat e njeriut, planeve mësimore të historisë dhe trajnimeve relevante, ndërmarrjes së hapave për edukim të publikut mbi vlerat e shumëllojshmërisë kulturore dhe inkluzionit me qëllim që të gjithë sektorët shtetërorë të kenë rol të caktuar në luftën me këtë mostolerancë.

ANEKSI

INCIDENTE TË KRIMEVE NGA URREJTJA PËR VITIN 2017

1. Diskriminim racor në Manastir (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në muret e Shkollës nëntëvjeçare “Gjorgji Sugarev” në Manastir janë vizatuar grafitë me kryqe të thyera dhe mesazhe të shkruara “Vdekje për evgjitët” dhe “Vdisni evgjitët”. Në shkollë shumica e nxënësve janë të bashkësisë etnike rome (rreth 80%). Pas reagimit të një grupi joformal qytetarësh përfaqësues të bashkësisë etnike rome nga Komuna e Manastirit, grafitët dhe shenjat svastike janë fshirë. Rasti është paraqitur në SPB Manastir.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 19 janar, rreth orës 00.30, SHN “Gjorgji Sugarev” Manastir.

Burimi i informacioneve: TV Tera, Manastir.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Shkaktim i urrejtjes, përçarjes ose intolerancë në bazë diskriminuese, kombëtare, racore fetare ose tjetër bazë (neni 319, KP i RM-së); Diskriminim racor ose tjetër (neni 417, KP i RM-së); Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së).

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është diskriminimi racor, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Përmbajtja e mesazheve të shkruara* – Mesazhe ofenduese dhe kërcënuese i drejtohen drejtpërdrejt bashkësisë etnike rome;

2. *Lokacioni i qëllimit* – mesazhet janë shkruar në murin e shkollës ku shumica e nxënësve i përkasin bashkësisë etnike rome.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se bëhet fjalë për vepër penale “dëmtim i objekteve të huaja”, e cila ndiqet me padi private dhe se SPB Manastir punon mbi ndriçimin dhe zbulimin e kryerësve.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e bashkësive të ndryshme etnike në shtet.

2. Zënkë midis gjimnazistëve nga Shkupi pas ndeshjes së futbollit (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Menjëherë pas përfundimit të ndeshjes së futbollit në nivel të shkollave të mesme në Shkup në shkollën e mesme “Zef Lush Marku”, në stacionin e fundit të autobusit numër 9, nxënësve të SHMSH Ilinden u është afruar një grup prej rreth 30 personash, pjesa më e madhe nxënës në SHMSH “Boro Petrushevski”, të cilët duke përdorur lëndë të ndryshme i kanë sulmuar nxënësit e SHMSH “Ilinden”. Pesë prej tyre kanë shkuar te drejtori dhe e kanë informuar drejtorin në lidhje me këtë ngjarje, më pas ai e paraqiti incidentin në EIK Shkup. Nxënësit të cilët kanë marrë lëndime, nga

drejtori janë dërguar në SPQ “Naum Ohridski” për t’iu dhënë ndihma mjekësore. Te personat D.M. (18) dhe D.A. (18) janë konstatuar lëndime të rënda trupore, kurse te B.C. (18) M.N. (18) dhe N.S. (18) janë konstatuar lëndime trupore. Në Buletin ditor të MPB-së është vendosur se po ndërmerren të gjitha masat për të ndriçuar tërësisht ngjarjen.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 7 shkurt, rreth orës 15:30, në afërsi të shkollës së mesme “Zef Lush Marku”.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, media elektronike MKD. mk; media elektronike Toçka.

Viktimat e involvuara: 5 nxënës të SHMSH “Ilinden”.

Lloji i krimeve: Lëndim trupor (neni 130, KP i RM-së), Lëndim i rëndë trupor (neni 131, KP i RM-së), Dhunë (neni 386, KP i RM-së)

Kryerësit: Një grup prej 30 kryerësish të panjohur

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident i cili ka ndodhur menjëherë pas mbajtjes të një evenimenti sportiv, motivi i njëanshëm është përkatësia etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorë të anshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – për shkak të përbërjes etnike të përzierë të nxënësve të cilët mësojnë në shkollat e përmendura, ka mundësi që përfaqësuesit e të dy grupeve të kenë përkatësi etnike të ndryshme;

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se në lidhje me ngjarjen juridike-penale nga SPB Shkup te PTHP Shkup është dërguar lajmërim me shkrim në lidhje me veprën penale “Dhunë” e paraparë dhe e dënueshme sipas nenit 386 të KP-së; KU nr. 1347/17.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Incidente të llojeve të tilla e vënë në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në shtet dhe bashkëjetesën midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri.

3. Janë sulmuar migrantë pakistanezë në afërsi të fsh. Bunarxhik (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Pasi NJIK është informuar me telefon se në autostradë Shkup-Kumanovë (në afërsi të fsh. Bunarxhik) ka dy persona të plagosur në kokë dhe në trup, nëpunësit policorë kanë dalë në vendngjarje dhe i kanë gjetur I.A.A. dhe F.K.A., shtetas të Pakistanit të cilët kanë hyrë në vend. Sipas rrëfimit të tyre, në urën për në fsh. Bunarxhik nga pesë të panjohur janë sulmuar me shkopinj druri dhe hekuri, dhe më pas ua kanë marrë paratë. I.A.S. në gjendje jokontabile dhe F.K.A. janë dërguar në Qendrën Mjekësore Shkup, ku u janë konstatuar lëndime të rënda trupore. Më 25.02.2017, mjeku i Klinikës së Neurokirurgjisë në Qendrën Klinike – Shkup, ka paraqitur se i lënduari I.A.S ka vdekur. Në buletin ditor të MBR-së thuhet se po merren masa për gjetjen e kryerësve dhe për ndriçimin e tërësishëm të rastit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 16 shkurt, ora 00:10, autostrada Shkup-Kumanovë, në afërsi të fshatit Bunarxhik.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Viktimat e involvuara: Dy pakistanezë.

Lloji i krimeve: Grabitje (neni 237, KP i RM-së), Dhunë (neni 386, KP i RM-së), Lëndim i rëndë trupor me pasojë vdekjeje (neni 131, KP i RM-së)

Kryerësit: 4-5 kryerës të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është statusi i migrantit apo refugjatit, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Model i incidenteve të mëparshme* – ky incident është ndjekur nga një trend rritës i grabitjeve dhe sulmeve mbi migrantët.

Statusi i rastit: I mbyllur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se në sulmi i përshkruar më sipër mbi dy shtetas palestinezë, migrantë është kryer nga 4-5 persona meshkuj të panjohur, gjatë kësaj u është marrë një unazë floriri dhe një telefon celular. Me urdhër të Prokurorit publik trupi i personit të vdekur është dërguar në obduksion, kurse shtetasi tjetër palestinez, që ishte së bashku me të ndjerin kur është kryer vepra penale nuk ka dashur të ngrejë raport për pranimin e fletëparaqitjes sepse ka dashur të largohet nga shteti dhe është lënë të largohet. MPB-ja nuk ka informacione se çfarë i janë marrë saktësisht personit të vdekur.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e migrantëve të cilët hyjnë dhe kalojnë nëpër shtet.

4. Është sulmuar Muhamed Zeqiri (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Deputeti i LSDM-së është sulmuar fizikisht nga dhjetëra persona në restorantin “Dion” në rr. “Kej 13 Nëntori”. Sipas dëshmive të tij, ai dhe miqtë e tij kishin rezervuar tavolinë në këtë objekt. Në një moment u është afruar personi N.M, person i punësuar si rojë personale e S.M., ish-drejtor i Drejtorisë për Sigurim dhe Kundërzbulim, i cili ishte ulur në një tavolinë me dhjetëra persona të panjohur dhe ka kërkuar ta lëshojnë objektin sepse në moment ka pasur një mbrëmje private. Pasi nuk kanë dalë jashtë menjëherë, N.M. e ka përmbytur tavolinën, kurse të tjerët nga shoqëria e tij, me dhunë, duke përdorur fuqi fizike, i ka kanë shtyrë para objektit. Siç ka paraqitur M.Z. një prej personave me legjitimacion zyrtar është legjitimuar se është nëpunës policor dhe ka kërkuar që ai të identifikohet. Në momentin kur e ka nxjerrë portofolin, nga pas një person i panjohur e ka goditur në pjesën qafës dhe kokës me disa goditje me dorë. Në buletin e MPB-së thuhet se po merren masa për zbardhjen e tërësishme të rastit.

Data, koha dhe vendi i incidentit : 18 shkurt, rreth orës 00:30, në një objekt hotelierik në rr. “Kej 13 Nëntori”, Shkup.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Media elektronike TV 21; media elektronike Sloboden pečat.

Viktimat e involvuara: Një person.

Lloji i krimeve: Lëndim trupor (Neni130, KP i RM-së), Dhunë (Neni 386, KP i RM-së)

Kryerësit: Grup prej dhjetëra kryerësish.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Perceptimi i viktimës* – sipas deklaratës së dhënë për mediat, viktimat e konsideron incidentin si incident me motivim të njëanshëm.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë nga MPB pas Kërkesës për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident, thuhet se pas dhënies së

ndihmës mjekësore për të dëmtuarin, nga nëpunësit policorë të SPB Shkup ai është dërguar të dorëzojë Raport për pranim të fletëparaqitjes në stacioni policor “Qendër”, kështu edhe ka bërë në lidhje me veprën penale të kryer “Dhunë” në përputhje me nenin 386 të KP-së. Njëkohësisht me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktive dhe zbardhjes së ngjarjes është biseduar edhe me D.B. (i punësuar si menaxher turni në lokal), kurse në lidhje me këtë ngjarje është informuar edhe prokurori publik i cili ka dhënë drejtime që të veprohet në përputhje me Ligjin për Kundërvajtje kundër Rendit dhe Qetësisë Publike. Në përputhje me nenin 282 LPP nga Njësia për Kriminal të Dhunshëm në SPB Shkup Prokurorisë Publike i është dorëzuar lajmërimi nr. 28.11.2/02-85 më 20.02.2017, që duke vepruar sipas këtij lajmërimi dhe me kërkesa të dërguara në PTHP Shkup, në drejtim të zbardhjes së ngjarjes janë ndërmarrë hapa dhe aktivitete të tjera, kurse për bisedim janë thirrur edhe tri persona. Njëkohësisht është siguruar edhe dokumentacioni i tërësishëm mjekësor nga Qendra Klinike “Nënë Tereza” në Shkup, si dhe nga DTUUD “Stenik Dion” SHPKNJP Shkup e obliguar për mbikëqyrjen me videon të vendosur në dhe para objektit hotelierik. Për masat e ndërmarra nga Njësia për Kriminal të Dhunshëm në SPB Shkup PTHP Shkup i janë dorëzuar dy lajmërimet (nr. 28.11.2-373 më 22.02.2017 dhe nr. 28.11.2-393 më 24.02.2017).

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

5. Tifozë të KF Shkupi kanë sulmuar adoleshentë (e pavërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy persona në moshë minore janë sulmuar nga një grup prej 20 deri në 30 persona, ndoshta tifozë të KF “Shkupi”. Pasi dy të miturit kanë dalë nga salla sportive “Kale” dhe janë drejtuar nga “Parku i qytetit” në afërsi të Akademisë “Vardar” kanë parë se drejt tyre po vinte një grup. Kur janë shkëmbyer një person nga grupi e ka goditur me grusht në pjesën e fytyrës një prej të miturve, kurse disa të tjerë e kanë sulmuar fizikisht të miturin tjetër duke e goditur me këmbë e me duar në pjesën e kokës dhe të trupit. Të miturit panë se një prej personave kishte thikë, kurse të tjerët kishin shkopinj prej metali të cilët nuk i kanë përdorur. Një prej personave të mitur me automjet të Ndhmës mjekësore të shpejtë është dërguar në SPQ “8 Shtatori” ku i është dhënë ndihma e parë dhe janë konstatuar lëndime trupore. Më parë, menjëherë pas ngjarjes, nga nëpunësit policorë, që ishin angazhuar ta sigurojnë ndeshjen e futbollit midis KF “Vardar” dhe KF “Shkupi” është intervenuar dhe në SP Qendër janë sjellë gjashtë persona nga Shkupi dhe një person nga Velesi. Në Buletinin e MBP-së shkruhet se po merren masa për zbardhjen e tërësishme të ngjarjes.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 19 shkurt, ora 13:30, në afërsi të Akademisë “Vardar”, Shkup.

Burimi i informacioneve: Gazeta ditore “Dnevnik”.

Viktimat e involvuara: Dy persona.

Lloji i krimeve: Lëndim trupor (Neni 130, KP i RM-së), Dhunë (Neni 386, KP i RM-së).

Kryerësit: Një grup prej 20 tifozësh të KF “Shkupi”.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident i cili ka ndodhur menjëherë pas përfundimit të një evenimenti sportiv, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia apo gjuha, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* – anëtarët e klubit të tifozëve të Vardarit dhe të Shkupit kanë prejardhje etnike të ndryshme;

2. *Koha* – incidenti ka ndodhur pas një ndeshjeje futbollit, midis klubeve “Vardar” dhe “Shkupi”, tifozët/mbështetësit e të cilëve kanë prejardhje etnike të ndryshme;

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë nga MPB-ja pas Kërkesës për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident, thuhet se në lidhje me këtë ngjarje juridike-penale nga SPB Shkup te PTHP Shkup është dorëzuar lajmërim me shkrim në lidhje me veprën penale “Dhunë” e paraparë dhe e dënueshme me nenin 386 të KP (KU. nr. 1743/17).

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Incidente të tilla e vënë në pikëpyetje gjendjen e tërësishme të sigurisë në shet, bashkëjetesën midis dy grupeve të ndryshme etnike në shoqëri dhe sigurinë e njerëzve të pranishëm në afërsi apo në ndeshjet sportive.

6. Rrahje e madhe në kejin e Vardarit në qendër të Shkupit (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Rrahje e madhe ku kanë marrë pjesë disa dhjetëra njerëz ka ndodhur në kejin e Vardarit në afërsi të T-Arenës kombëtare. Sipas informacioneve jozyrtare të dëshmitarëve, zënka ka ndodhur midis grupeve të tifozëve të Vardarit dhe Shkupit, pak para fillimit të ndeshjes para tribunave boshe (duke pasur parasysh se Vardari është dënuar nga Federata e Futbollit që të luajë në stadium bosh) dhe ka pasur më tepër persona të lënduar, kurse janë arrestuar edhe disa prej tyre. Të njëjtën mbrëmje, sipas informacioneve të MPB-së, të marra nga mediat, një grup të rinjsh, ndoshta anëtarë të grupit të tifozëve “Komitë” të revoltuar nga arrestimet të anëtarëve të tyre kanë marrë pjesë në prishjen e rendit dhe qetësisë publike të ndeshjes së futbollit midis KG “Vardar” dhe KF “Shkupi” i cili u mbajt në stadiumin “Filipi II” në Shkup, të organizuar në dy grupe kanë filluar të gjuajnë me gurë dhe me objekte të tjera të forta mbi objektin ku është vendosur Stacioni policor “Qendër”

Data, koha dhe vendi i incidentit: 19 shkurt, rreth orës 15:20, keji i Vardarit, Shkup.

Burimi i informacioneve: Medie elektronike Press24.mk.

Viktimat e involvuara: 2 persona.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP i RM-së), Lëndim trupor (Neni 130, KP i RM-së), Pjesëmarrje në rrahje (Neni 132, KP i RM-së)

Kryerësit: Një grup prej një numri të panjohur tifozësh nga grupet e tifozëve të Vardarit dhe Shkupit.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, i cili ka ndodhur pak kohë para mbajtjes së ndeshjes sportive, motivi i anshëm është prejardhja etnike, nënshtetësia ose gjuha, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* – anëtarët e klubeve të tifozëve të klubeve të futbollit Vardar dhe Shkup kanë prejardhje të ndryshme etnike;
2. *Koha* – Incidenti ka ndodhur pas ndeshjes së futbollit midis klubeve tifozët/mbështetësit e të cilëve kanë prejardhje të ndryshme etnike.
3. *Model i incidenteve të mëparshme* - këtij incidenti i paraprin incident në të njëjtën ditë, kur dy të mitur, ndoshta tifozë të KF “Vardar” janë sulmuar nga tifozë të KF “Shkupi”.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë nga MPB-ja pas Kërkesës për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident, thuhet se në lidhje me këtë ngjarje juridike-penale nga SPB Shkup te PTHP Shkup është dorëzuar lajmërim me shkrim në lidhje me veprën penale “Dhunë” e paraparë dhe e dënueshme me nenin 386 të KP (KU. nr. 1743/17).

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Incidente të tilla e vënë në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë midis grupeve të ndryshme etnike në shoqëri dhe sigurinë e njerëzve që janë të pranishëm apo janë në afërsi të ndeshjeve sportive.

7. Është sulmuar një studente për shkak të përkatësisë etnike dhe bindjes fetare (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Vajzë, studente në Fakultetin Juridik Justiniani I, e cila ka pasur shami në kokë, është sulmuar fizikisht dhe verbalisht nga një grup meshkujsh në Sheshin “Makedonija” në Shkup. Sulmuesit janë përpjekur që t’ia heqin shaminë nga koka, duke e quajtur “terrorist”, “shqiptare e ndyrë” dhe duke i thënë “marsh në Arabi”. Në vendngjarje disa qytetarë e kanë paralajmëruar grupin, pas këtij paralajmërimi grupi u shpërnda menjëherë.

Data, koha dhe vendi i incidentit : 23 shkurt, rreth orës 14:00, Sheshi “Makedonija”, Shkup

Burimi i informacioneve: Rasti është paraqitur në polici dhe në Komitetin e Helsinkit nga një e njohura e një studenteje.

Viktimat e involvuara: Një person.

Lloji i krimeve: Rrezikim i sigurisë (Neni144, KP i RM-së), Dhunë (Neni 386, KP i RM-së)

Kryerësit: Një grup kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia etnike, shtetësia apo gjuha, përkatësisht përkatësia fetare apo bindja fetare, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Përmbajtja e mesazheve të dhëna* – Mesazhe kërcënuese dhe ofenduese ndaj viktimës sepse mban shami, të cilën sulmuesit janë përpjekur t’ia heqin.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë nga MPB-ja pas Kërkesës për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident, shkurtimisht përmendet se pas paraqitjes së kësaj ngjarjeje nga e dëmtuara më 27 shkurt 2017 në SP “Qendër” në stacionin policor është mbajtur procesverbal për paraqitje të ngjarjes.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e bashkësive të ndryshme etnike përkatësisht të bashkësive fetare në shtet.

8. Janë thyer dritaret e shtabit të LSDM-së në Draçevë (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Persona të panjohur me gurë i kanë thyer xhamat e jashtëm të shtabit të LSDM-së në fshatin Draçevë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 24 shkurt, rreth orës 01:10, shtabi i partisë LSDM në fshatin Draçevë.

Burimi i informacioneve: Medie elektronike meta.mt; TV Tera.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së).

Kryerësit: Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – Lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë nga MPB-ja pas Kërkesës për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident, thuhet se në lidhje me këtë ngjarje është bërë procesverbal për praninë të fletëparaqitjes dhe shënimit zyrtar, kurse nga Njësia për Hetim në Vëndndodhje është kryer përpunim krim teknik.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

9. Është qëlluar me gurë shtabi i LSDM-së në Prilep (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Shtabi lokal i LSDM-së në lagjen Varosh, Prilep është shkatërruar në orët e hershme të mëngjesit. Sipas informacioneve nga LSDM-ja Prilep, shtabi është qëlluar me gur, duke u thyer kështu xhamat e jashtëm të shtabit.

Data, koha dhe vendi i incidentit : 24 shkurt, ora 02:00, shtabi i LSDM-së në lagjen Varosh, Prilep.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Sloboden pečat, A1on.MK.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së).

Kryerësit: Të panjohur..

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – Lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – Këtij incidenti i ka paraprirë incident në të njëjtën ditë, kur është shkatërruar shtabi i LSDM-së në fsh. Draçevë.

Statusi i rastit: Nuk është regjistruar.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se një rast i tillë nuk është evidentuar.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

10. Janë thyer xhamat e shtabit të LSDM-së në Sopishte (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në fshatin Sopishte, Shkup në afërsi të unazës nga një kryerës i panjohur, në një kohë të pacaktuar, është kryer dëmtim i shtabit të partisë politike LSDM, ku janë thyer dy xhama dritaresh. Në Buletinin e MPB-së thuhet se po merren masa për zbulimin e kryerësit dhe për zbardhjen e tërësishme të rastit.

Data, koha dhe vendi i incidentit : 26 shkurt, ora 01:00, shtabi partiak i LSDM-së në fsh. Sopishte.

Burimi i informacioneve: Buletini ditore i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Media elektronike Sloboden pečat.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së).

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – Lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – Këtij incidenti i kanë paraprirë incidente para dy ditësh, kur janë dëmtuar shtabet partiake të LSDM-së në Prilep dhe në fsh. Draçevë.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë nga MPB-ja pas kërkesës për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident, thuhet se partia LSDM më 02.03.2017 ka dorëzuar procesverbal mbi pranimin e fletëparaqitjes për këtë incident, për të cilin

thuhet se ka ndodhur natën midis 25 dhe 26 shkurtit 2017 midis orës 21 dhe 06 kur janë thyer tre xhama të dritaresh dhe është shkaktuar dëm me vlerë prej 7000 denarësh. Nuk jepen se çfarë veprimesh të tjera janë ndërmarrë nga MPB në drejtim të zbardhjes së këtij incidenti.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

11. Janë thyer xhama të shtabit të LSDM-së në Manastir (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Shtabi i LSDM-së në lagjen Karposh në Manastir është gjuajtur me gurë, kështu që janë thyer dritaret, kurse është demoluar edhe inventari në këtë hapësirë. Sipas informacioneve të transmetuara nga mediat, policia e Manastirit ka bërë mbikëqyrje në vendngjarje dhe ka marrë masat për zbulimin e kryerësve.

Data, koha dhe vendi i incidentit : 26 shkurt, ora 13:30, shtabi i LSDM-së në lagjen Karposh në Manastir.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Reporter.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së).

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – Lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – Këtij incidenti i kanë paraprirë incidente para dy ditësh, kur janë gjuajtur me gurë shtabet partiake të LSDM-së në Prilep, në fsh. Draçevë dhe në fsh. Sopsishte.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se bëhet fjalë për veprën penale “Dëmtim i objekteve të huaja” që ndiqet me padi private, si dhe se SPB Manastir po punon në zbardhjen dhe zbulimin e kryerësve.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

12. Është gjuajtur me gurë edhe një shtab i LSDM-së në Prilep (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Shtabi i partisë politike LSDM në lagjen Bonçejca në Prilep është gjuajtur me gurë, duke u dëmtuar kështu një xham i jashtëm.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 26 shkurt, rreth orës 13:30, shtab i LSDM-së në Prilep.

Burimi i informacioneve: Media elektronike A1On.mk.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së).

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm : Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – Lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – Këtij incidenti i kanë paraprirë incidente para dy ditësh, kur janë gjuajtur me gurë shtabet partiake të LSDM-së në Prilep, në fsh. Draçevë. në fsh. Sopsishte dhe në Manastir.

Statusi i rastit: Nuk është regjistruar.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se një ngjarje e tillë nuk është evidentuar.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

13. Janë sulmuar pesë persona në qendër të Shkupit (e pavërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në rrugën “Maqedonia” në Shkup, ndërkohë që 24-vjeçari nga Feriza/Uroševac j ka shëtitur me shokët e tij, R.U, F.U., A.M., dhe R.U., janë sulmuar fizikisht nga një grup më i madh të rinjsh, të cilët më pas kanë ikur në drejtim të panjohur. Sipas informacioneve të transmetuara nga mediat, policia është informuar se i sulmuari është dërguar në spital në Shkup ku i është dhënë ndihmë mjekësore, kurse janë arrestuar personat S.N. (19), A.Z. (19), N.M.(19) dhe dy të mitur në moshë 15 dhe 16-vjeçare, të gjithë nga Shkupi. Pas bisedës informatorë, të miturit janë lënë të lirë, kurse personat e tjerë janë mbajtur në procedurë të mëtejshme. Mediumi informon se po merren masat për zbardhje të tërësishme të rastit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 26 shkurt, ora 17:00, rr. “Makedonija”, Shkup.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Skopje24.mk.

Viktimat e involvuara: 5 persona.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP i RM-së), Lëndim trupor (Neni 130, KP i RM-së).

Kryerësit: Grup prej 5 personash, midis të cilëve dy të mitur.

Përshkrim i shkurter i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar sipas prejardhjes etnike* – viktimat janë banorë kosovarë.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik;

Statusi i rastit: Është ngritur fletëparaqitje penale kundër pesë personave për veprën penale “Pjesëmarrje në turmë” që kryen vepër penale në përputhje me nenin 385 të Kodit Penal.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se pas marrjes së masave dhe aktiviteteve nga SPB Shkup te Prokuroria Themelore Publike Shkup është dorëzuar kallëzim penal (KU nr.2351/17) kundër pesë personave se ekzistojnë baza të dyshimit për kryerjen e veprës penale “Pjesëmarrje në turmë” që do të kryhet në përputhje me nenin 385 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

14. Është thyer shtabi i LSDM-së në Aerodrom (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Kryerës i panjohur me një mjet të përshtatshëm e ka thyer xhamin e vitrinës së shtabit partiak të LSDM-së në lagjen Aerodrom, Shkup.

Data, koha dhe vendi i incidentit : 27 shkurt, rreth orës 01:20, shtabi partiak i LSDM-së në l. Aerodrom, Shkup.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Mkd.mk.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktime.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së).

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – Lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* – Këtij incidenti i kanë paraprirë incidente para dy ditësh, kur janë gjuajtur me gurë shtabet partiake të LSDM-së në Prilep, në fsh. Draçevë. në fsh. Sopsishte dhe në Manastir.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se bëhet fjalë për veprën penale “Dëmtim i objekteve të huaja” që ndiqet me padi private, në përputhje me nenin 243 të KP-së dhe se po merren masa dhe aktivitete për zbardhjen e ngjarjes.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

15. Është gjuajtur me gurë shtabi i LSDM-së në qendër të Shkupit (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Kryerës i panjohur duke përdorur një lëndë të fortë ka thyer xhamat e vitrinës dhe xhamin e derës hyrëse në shtabin e partisë politike LSDM që gjendet në bul. “Mitropolit Teodosij Golloganov”.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 28 shkurt, rreth orës 01:30, shtabi partiak i LSDM-së në qendër të Shkupit.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Mkd.mk.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së).

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm : Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – Lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* – Këtij incidenti i kanë paraprirë incidente para dy ditësh, kur janë gjuajtur me gurë shtabet partiake të LSDM-së në Prilep, në fsh. Draçevë. në fsh. Sopsishte, në Manastir dhe në l. Aerodrom në Shkup.

Statusi i rastit: I mbyllur, nuk është përcaktuar ngjarje penale juridike apo ngjarje kundërvajtëse.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nga i paraqituri nuk është dorëzuar procesverbal për paraqitje në stacionin policor, prandaj nuk është përcaktuar ngjarje juridike penale apo ngjarje kundërvajtëse.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

16. U shkatërrua klubi ku mbledheshin donacione për Revolucionin Laraman (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në orët e vona të natës janë thyer xhamat e klubit “Izlet”, ku mbahen evenimente për mbledhjen e donacioneve për pagim të fletëparaqitjeve penale për hedhjen e tullumbaceve të mbushura me bojë nga demonstruesit e Revolucionit Laraman.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 28 shkurt, rreth orës 04:00, klub “Izlet”, Shkup

Burimi i informacioneve: Gazeta ditore “Fokus”.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP i RM-së)

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është klubi i njohur për mbajtjen e evenimenteve për mbledhje të donacioneve për pagim të të fletëparaqitjeve penale për hedhjen e tullumbaceve të mbushura me bojë nga demonstruesit e Revolucionit Laraman.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – Këtij incidenti i pararendin incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet partiake të LSDM-së në shumicën e qyteteve në shtet.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se bëhet fjalë për veprën penale “Dëmtim i objekteve të huaja”, që ndiqet me padi private në përputhje me nenin 243 prej KP-së dhe po merren ende masa dhe aktivitete për zbardhjen e ngjarjes.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

17. Një grup ka sulmuar një të mitur në autobusin nr. 58 të NPQ-së (e pavërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në stacionin e autobusit para QT “Vero Xhambo”, në autobusin e PPS-së nr. 58, i cili ka qarkulluar në drejtim të Qendrës së transportit, ka hyrë një grup më i madh të rinjsh në moshë nga 16-18 vjet dhe pasi autobusi ka filluar të lëvizë, personat kanë sulmuar fizikisht një të mitur 17-vjeçar nga autobusi dhe kanë thyer nga një xham. Pasi autobusi ka ndaluar në stacionin e Qendrës Tregtare, kryerësit kanë dalë dhe kanë shkuar në drejtime të ndryshme. Pas ngjarjes i dëmtuari është pranuar në qendrën klinike “Nënë Tereza” – Klinika e Urgjencës, ku i janë konstatuar lëndime trupore. Nga nëpunësit policorë të SPB-së Shkup janë ndërmarrë masa për zbardhje të ngjarjeve, kështu për prishje të rendit publik dhe paqes me elemente dhune në Stacionin policor me kompetencë të përgjithshme “Qendër” nga Njësia Alfa janë privuar nga liria dhe janë thirrur 9 (nëntë) persona prej të cilëve pesë persona në moshë nga 14 deri në 18 vjet si kryerës të mundshëm të dhunës, kurse të tjerët në rolin e dëshmitarëve në ngjarje. Në prani të prindërve dhe avokatëve të kryerësve të mundshëm është kryer bisedë, pas së cilës personat e mitur janë lëshuar, kurse një person në moshë madhore është mbajtur në stacion.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 28 shkurt, rreth orës 13:00, autobus i NPP-së nr. 58.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Viktimat e involvuara: Një person i mitur.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP i RM-së), Lëndim trupor (Neni 130, KP i RM-së)

Kryerësit: Një grup prej pesë personash, midis të cilëve katër të mitur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – incidenti ka ndodhur në autobus i cili ka qarkulluar në rajone të banuara me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se SPB-ja Shkup te Prokuroria Themelore Publike ka dorëzuar lajmërim me shkrim (KU nr. 2285/17) për veprën penale të paraqitur “Dhunë” në përputhje me nenin 386 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

18. Është qëlluar me gurë shtabi i LSDM-së në Kisella Vodë (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy persona me kapele në kokë kanë qëlluar me gurë shtabin partiak të LSDM-së në Rasadnik-Kisella Vodë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 28 shkurt, ora 13:15, shtabi partiak i LSDM-së në Rasadnik-Kisella Vodë, Shkup.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Plusinfo.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së).

Kryerësit: Dy persona.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – Lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – Këtij incidenti i kanë paraprirë incidente para dy ditësh, kur janë dëmtuar shtabet partiake të LSDM-së në Prilep, në fsh. Draçevë. në fsh. Sopsishte, në Manastir dhe në lagjet Qendër dhe Aerodrom në Shkup.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se bëhet fjalë për veprën penale “Dëmtim i objekteve të huaja”, e cila ndiqet me padi private, në përputhje me nenin 243 të KP-së dhe se po merren masa dhe aktivitete për zbardhjen e ngjarjes.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

19. Janë lënduar të rinj pas incidentit për shkak të përkatësisë etnike (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy persona janë lënduar gjatë një zënke në qendër të Shkupit. Në stacionin e autobusit te Banka Popullore janë zënë dy grupe dhe janë lënduar dy persona, prej të cilëve njëri nga fshati Brazda dhe tjetri nga fshati Sopsishte. Njëri prej të lënduarve është 17-vjeçar, kurse tjetri është 19-vjeçar. Ekipi i TV 24 në momentin e incidentit ka qenë në vendngjarje ku ka vënë re praninë e automjetit të ndihmës së shpejtë, si dhe policinë, e cila nuk lejoi qasjen e ekipit në vendngjarje. Sipas informacioneve të transmetuara nga mediumet, në këtë ballafaqim fizik është lënduar i biri i një prej kryetarëve të komunave të Shkupit. Mediumi transmeton se i mituri është mbajtur në Qendrën klinike me lëndime në pjesën e kokës, kurse pastaj në Qendrën e Urgjencës është sjellë edhe një person tjetër, si dhe se MPB-ja po punën në zbardhjen e tërësishme të rastit. Sipas gazetares së Al Xheziras Shkup – Millka Smilevska, incidenti është kryer nga përfaqësues të bashkësisë shqiptare, si hakmarrje për incidentin me sulmin fizik dhe verbal mbi studenten shqiptare, që ka ndodhur në

Sheshin “Makedonija” në Shkup. (<http://www.zlostorstvaodomraza.com/reports/view/377>). Ajo këtë informacion e ka marrë personalisht në Qendrën e Urgjencës Shkup.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 28 shkurt, rreth orës 19, në stacionin e autobusit te Banka Popullore, Shkup.

Burimi i informacioneve: Media elektronike 24Vesti, Facebook-profli i gazetares Millka Smilevska nga Al Xhezira Ballkan.

Viktimat e involvuara: Dy persona.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni386, KP i RM-së), Lëndim trupor (Neni130, KP i RM-së)

Kryerësit: Grup prej disa personash.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – për shkak të vendndodhjes së incidentit i cili ka ndodhur në stacion autobusi, ku qëndrojnë autobusë të cilët qarkullojnë në fusha me përbërje etnike të përzierë, supozohet se përkatësia etnike e kryerësve ndryshon nga ajo e viktimave.

2. *Natyra e dhunës* – supozohet se ky incident është hakmarrje për incidentin para pesë ditësh, kur një grup prej disa personash meshkuj, e kanë sulmuar fizikisht dhe verbalisht një studente shqiptare në qendër të Shkupit.

Statusi i rastit: Është dorëzuar fletëparaqitje penale kundër një personi për kryerje të veprës penale “Dhunë” në përputhje me nenin 386 të KP-së.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se pas masave dhe aktiviteteve të ndërmarra nga SPB-ja Shkup te Prokuroria Themelore Publike Shkup është dorëzuar fletëparaqitje penale (KU nr. 2283/17) kundër një personi për kryerje të veprës penale “Dhunë” në përputhje me nenin 386 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike në bashkësi.

20. Është sulmuar një i mitur te Qendra e transportit (e pavërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një pesëmbëdhjetëvjeçar nga fsh. Kadino, pa shkas dhe arsye, është sulmuar fizikisht nga pesë-gjashtë persona të mitur prej 16 deri në 18 vjet para biletarisë së NPQ-së në Qendrën e transportit. Në Buletinin ditor të MPB-së thuhet se po merren masa për gjetjen e kryerësve dhe për zbardhje të tërësishme të ngjarjes.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 01 mars, ora 18:35, Qendra e transportit, Shkup.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Media elektronike 24Vesti

Viktimat e involvuara: Një person.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni386, KP i RM-së)

Kryerësit: Grup prej 5-6 personash.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – incidenti ka ndodhur në Qendrën tregtare, ku kalojnë autobusë të cilët qarkullojnë nëpër rajone të populluara nga persona me përbërje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se bëhet fjalë për shkeljen “Sulm fizik” në përputhje me nenin 12 të LSHRPP-së dhe ende po merren masa për zbardhjen e ngjarjes.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

21. Dy persona janë rrahur në një ëmbëltore në lagjen Aerodrom (e pavërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy persona F.C. (19) dhe A.M. (20) në një ëmbëltore në rr. “Vladimir Komarov” në Shkup, pa asnjë shkas dhe arsye janë sulmuar fizikisht nga pesë-gjashtë persona meshkuj të panjohur, të cilët kanë qenë në këtë ëmbëltore. F.C. dhe A.M. janë dërguar në spitalin “Remedika”, ku nga mjeku te F.C. janë konstatuar lëndime të rënda trupore. Në buletinin ditor të MPB-së thuhet se po merren masat për gjetjen e kryerësve dhe për zbardhjen e tërësishme të ngjarjes.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 01 mars, rreth orës 20:00, ëmbëltore në rr. “Vladimir Komarov”, Shkup.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Media elektronike Press 24Vesti.mk

Viktimat e involvuara: Dy persona.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni386, KP i RM-së), Lëndim trupor (Neni130, KP i RM-së), Lëndim trupor i rëndë (Neni131, KP i RM-së)

Kryerësit: Grup prej 5-6 personash.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – për shkak të përbërjes së përzierë etnike të personave të cilët shkojnë në ëmbëltore, ka mundësi që përfaqësuesit e të dyja grupeve të kenë prejardhje të ndryshme etnike.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën Komiteti ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se SPB Shkup te Prokuroria Themelore Publike ka dërguar informim me shkrim dhe lajmërim (KU nr. 2284/17) për vepër penale të paraqitur Dhunë në përputhje me nenin 386 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

22. Është sulmuar një djalosh në autobusin nr.68 të NQP-së (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një person në moshë 18-vjeçare pa shkas dhe arsye është sulmuar fizikisht nga shtatë-tetë persona të panjohur në autobusin e NQP-së me nr. 68, i cili ka lëvizur në relacionin kinema “Maxhari” deri në “ASUC”. Pas sulmit kryerësit kanë ikur në drejtim të panjohur. Në buletinin ditor të MPB-së thuhet se po merren masat për gjetjen e sulmuesve dhe për zbardhjen e tërësishme të rastit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 02 mars, rreth orës 12:30, autobus i NQP-së nr. 68.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Media elektronike Plusinfo.

Viktimat e involvuara: Një person.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP i RM-së)

Kryerësit: Grup prej 7-8 kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – Incidenti ka ndodhur në autobusin nr. 69 të NQP-së që qarkullon rajone të populluara nga njerëz me përbërje etnike të përzierë, destinacioni i fundit është shkolla ku mësojnë nxënësit me përbërje të ndryshme etnike.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – ky incident është edhe një incident tjetër nga trendi zmadhues i rrahjeve në autobusin nr. 68 të NQP-së.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se bëhet fjalë për shkelje “Sulm fizik” në përputhje me nenin 12 të Ligjit për Kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë dhe se po merren masa për zbardhjen e ngjarjes.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

23. Është sulmuar në autobusin nr. 50 të NQP-së Shkup (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në stacionin e autobusit të “ASUC” në lagjen Autokomandë, në autobusin nr. 50 disa persona të panjohur kanë sulmuar fizikisht një person gjashtëmbëdhjetë vjeçar, pas kësaj kanë zbritur dhe janë larguar në drejtim të panjohur. Në buletin ditë të MPB-së thuhet se po merren masa për gjetjen e kryerësve dhe për zbardhjen e tërësishme të ngjarjes.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 02 mars, rreth orës 13:00, autobus i NQP-së nr. 50.

Burimi i informacioneve: Buletini ditë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Media elektronike Mkd.mk.

Viktimat e involvuara: Një person i mitur.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP i RM-së)

Kryerësit: Një grup prej disa kryerësish të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – incidenti ka ndodhur në autobusin e NQP-së nr. 50, në stacionin e autobusit para shkollës ku mësojnë nxënës me përbërje të ndryshme etnike.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshëm* – ky incident është edhe një incident tjetër nga trendi zmadhues i rrahjeve në autobusin nr. 50 të NQP-së

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se bëhet fjalë për shkeljen “Sulm fizik” në përputhje me nenin 12 të LSHPRPP-së dhe se po merren masa për zbardhjen e ngjarjes.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

24. Janë thyer xhamat e shtabit të LSDM-së (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Nga persona të panjohur janë thyer xhamat e shtabit të partisë politike LSDM, në rrugën Juznomoravski brigadi në lagjen Çento.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 3 mars, rreth orës 03:00, Shtabi partiak i LSDM-së në lagjen Çento, Shkup.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Biznis vesti.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së).

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i partisë politike.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – Këtij incidenti i kanë paraprirë incidente nga muaji i mëparshëm, kur janë dëmtuar shtabet partiake të LSDM-së në Prilep, Manastir dhe në shumë lagje të Shkupit.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se bëhet fjalë për veprën penale “Dëmtim i objekteve të huaja” që ndiqet me padi private në përputhje me nenin 243 të KP-së dhe po merren masa dhe aktivitete për zbardhjen e rastit.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

25. Muzeu i alfabetit të gjuhës shqipe është sulmuar me kokteje molotov (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Katër persona të maskuar kanë gjuajtur me kokteje molotov mbi Muzeun e Alfabetit Shqip në Manastir. Personat kanë dashur t’i vënë zjarrin objektit, por nuk e kanë arritur qëllimin, kështu që kanë thyer vetëm xhamat. Një pjesë e xhamave të dritareve të Muzeut dhe të derës hyrëse janë thyer, kurse para hyrjes ka shenja të dukshme të koktejit molotov.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 07 mars, rreth orës 04, Muzeu i Alfabetit Shqip, Manastir.

Burimi i informacioneve: Media elektronike TV Tera, Media elektronike Reporter.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së), Shkaktim i urrejtjes, përçarjes apo mostolerancës në bazë diskriminuese nacionale, racore, fetare apo tjetër bazë diskriminuese. (Neni 319, KP i RM-së)

Kryerësit: Katër persona.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia etnike, kombësia ose gjuha, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është Muzeu i Alfabetit Shqip në Manastir.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – ky është sulmi i pestë mbi Muzeun e Alfabetit Shqip në Manastir.

Statusi i rastit: Është dorëzuar fletëparaqitje penale, kundër katër personave sepse ekzistojnë baza të dyshimit për kryerjen e veprës penale Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm sipas nenit 288 të KP-së.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se po merren masat, nga SPB-ja Manastir është dorëzuar fletëparaqitje penale kundër katër personave sepse ekzistojnë baza të dyshimit për kryerjen e veprës penale “Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm” sipas nenit 288 të KP-së. Mandej, në përgjigje thuhet se pas bisedave të kryera me personat e paraqitur, nga SPB-ja Manastir nuk janë

konstatuar indikacione të cilat dëshmojnë se incidenti është kryer për shkak të përkatësisë etnike të personave, por është kryer me vetiniciativë dhe pa kurrfarë ndikimesh.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

26. Është sulmuar aktivistja e LSDM-së nga Prilepi (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Suzana Trajkovska, aktiviste e LSDM-së në Prilep, është ndalur dhe sulmuar nga dy persona të panjohur, fytyrat e të cilëve nuk ka pasur mundësi t'i shohë sepse i kishin të mbuluara me maska. Sipas thënieve të saj, personat i janë afruar nga pas, e kanë kapur fort, e kanë ngritur, kurse pastaj e kanë paralajmëruar të mos shohë as majtas, as djathtas dhe i janë drejtuar me fjalët "Shumë po eksponohesh nëpër televizion dhe nëse vazhdon kështu do të të fshijmë. Pastaj e kanë lëshuar me paralajmërim që të mos kthehet pas tyre, ndërsa po iknin. Personat kanë pasur maska të zeza të thurura, dukserë të zinj me kapele dhe sipas saj kanë qenë mbi tridhjetë vjet.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 16 mars, ora 21:00, rr. Republikanska, Prilep

Burimi i informacioneve: Media elektronike Plusinfo

Viktimat e involvuara: Një person.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP i RM-së), Rrezikim i sigurisë (Neni144, KP i RM-së)

Kryerësit: Dy persona.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Përmbajtja e mesazheve të dhëna* – Mesazhet ofenduese dhe kërcënuese i janë drejtuar viktimës sepse eksponohet si aktiviste politike.

2. *Perceptimi i viktimës* – sipas deklaratës të dhënë për mediat, viktimat e konsideron incidentin me motivim të njëanshëm.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se pas marrjes së fletëparaqitjes, nga nëpunësit policorë është përgatitur procesverbal për pranim të fletëparaqitjes për veprën penale sipas neni 144 paragrafi 1 "Rrezikim i sigurisë" që ndiqet me padi private, si dhe se SP Prilep po punon mbi zbardhjen dhe zbulimin e kryerësve.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

27. Është goditur me gurë shtabi i VMRO-DPMNE-së në Çair (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një person ka paraqitur se ndërsa ka qenë brenda në shtabin e partisë politike VMRO-DPMNE në rr. "Cvetan Dimov" nga persona të mitur është dëmtuar me hedhje të gurëve xhami i dritares. Në Buletinin ditor të PMB-së thuhet se po merren masat për zbardhjen e rastit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 18 mars, rreth orës 22:45, shtabi partiak i VMRO-DPMNE-së në lagjen Çair, Shkup.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimat.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP i RM-së)

Kryerësit: Grup personash të mitur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar shtabi i partisë politike.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* – Këtij incidenti i paraprijnë incidentet e muajit të kaluar, kur janë dëmtuar shtabet partiake të LSDM-së në shumë qytete të shtetit.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se bëhet fjalë për veprën penale “Dëmtim i objekteve të huaja” e cila ndiqet me padi private në përputhje me nenin 243 të KP-së dhe se po merren masa dhe aktivitete për zbardhjen e ngjarjes.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

28. Një nxënës është sulmuar në furgon për pasagjerë (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një person 17-vjeçar, ndërsa po udhëtonte me furgon në drejtimin Kumanovë-Shkup, në bul. “3-ta Makedonska Brigada” në Shkup, në afërsi të shkollës SHMQSH “Maria Kiri Sklodovska”, është sulmuar fizikisht nga gjashtë persona të panjohur, ndoshta nxënës që kanë udhëtuar me të njëjtin furgon dhe pasi e kanë pyetur për diçka e kanë goditur me boks në pjesën e kokës, pas goditjes ai ka rënë. Sipas informacioneve të transmetuara nga mediat, sipas fjalëve të viktimës dhe të babit të tij, së pari i është afruar njëri prej personave, kurse pastaj i janë bashkangjitur edhe personat e tjerë dhe e kanë kërcënuar dhe i kanë thënë të mos vijë më në shkollë, pastaj e kanë sulmuar fizikisht dhe e kanë goditur me bokse dhe shqelma në kokë dhe trup. Në afërsi të SHMQSH “Dimitar Vllahov” i mituri ka zbritur dhe e ka paraqitur ngjarjen te nëpunësit policorë. Nga sulm fizik, personi ka marrë lëndime në pjesën e kokës dhe të trupit. Janë marrë masa për zbardhje të tërësishme të ngjarjes.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 22 mars, ora 13:30, në furgon në drejtimin Kumanovë-Shkup.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Media elektronike TV 21.

Viktimat e involvuara: Një person i mitur.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP i RM-së), Lëndim trupor (Neni 130, KP i RM-së), Rrezikim i sigurisë (Neni 144, KP i RM-së)

Kryerësit: Grup prej 3-6 personash.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* – meqenëse nxënësit që mësojnë në shkollën e dhënë, kanë prejardhje të ndryshme etnike, ka mundësi që kryerësit dhe viktimat të kenë prejardhje të ndryshme etnike.

Statusi i rastit: Është dorëzuar fletëparaqitje penale kundër tri personave sepse ekzistojnë baza të dyshimit për kryerje të veprës penale „Dhunë“ sipas nenit 386 të KP-së.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se po merren masat dhe aktivitetet, nga SPB Shkup te Prokuroria Themelore Publike Shkup është dorëzuar fletëparaqitje penale (KU nr. 2993/17) kundër tri personave sepse ekzistojnë baza të dyshimit për kryerje të veprës penale „Dhunë“ sipas nenit 386 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

29. Janë sulmuar të mitur në lagjen Aerodrom, Shkup (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një 17-vjeçar së bashku me shokun e tij janë sulmuar fizikisht nga rreth 20 persona të panjohur në autobusin e NQP-së Shkup me nr. 7. Në stacionin e autobusit në bul. “3-ta Makedonska brigada”, në afërsi të SHMQSH “Maria Kiri Skllodovska” në autobus kanë hipur rreth 20 persona të panjohur në moshë nga 14 deri në 18 vjet. Disa prej tyre e kanë tërhequr të miturin dhe kur e kanë nxjerrë jashtë e kanë sulmuar duke e goditur me duar edhe me këmbë në pjesën e trupit. Pastaj i janë kthyer shokut të tij dhe kanë nisur ta godasin me pëllëmbë pas koke, por ai arriti të largohet. Po merren masa për zbardhjen e tërësishme të ngjarjes.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 22 mars, ora 14:00, autobus i NQP-së nr. 7

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Viktimat e involvuara: Dy persona të mitur.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP i RM-së), Lëndim trupor (Neni130, KP i RM-së)

Kryerësit: Grup 3-4 personash.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm : Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – Incidenti ka ndodhur në autobusin nr. 7 të NQP-së i cili qarkullon nëpër rajone të banuara nga njerëz me përbërje të ndryshme etnike; stacioni ku kanë hyrë kryerësit në autobus gjendet para një shkolle ku mësojnë nxënës me përbërje të ndryshme etnike.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – ky incident është edhe një incident tjetër nga trendi në rritje i rrahjeve në autobusët e NQP-së.

Statusi i rastit: Është dorëzuar fletëparaqitje penale kundër tre personave për veprën penale “Dhunë” sipas nenit 386 të KP-së. .

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se gjatë kësaj ngjarjeje është sulmuar fizikisht një person (17) nga 3-4 persona të panjohur. Pas masave dhe aktiviteteve të ndërmarra nga SPB Shkup te PTHP Shkup është dorëzuar fletëparaqitje penale (KU. nr 2993/17) kundër 3 personave sepse ekzistojnë baza dyshimi për kryerjen e veprës penale “Dhunë” në përputhje me nenin 386 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

30. Është qëlluar me gurë shtabi i LSDM-së në Aerodrom (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: gjatë natës kur anëtarët e LSDM-së kanë pasur mbledhje, është gjuajtur me gurë shtabi i tyre në Aerodrom. Gjatë sulmit janë thyer disa dritare. Sipas informacioneve të transmetuara nga mediat, përveç dëmit material nuk ka të lënduar.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 22 mars, ora 20:00, shtabi partiak i LSDM-së, në lagjen Aerodrom, Shkup.

Burimi i informacioneve: Media elektronike A1on.mk.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së).

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* - Këtij incidenti i paraprijnë incidentet e muajit të kaluar, kur janë dëmtuar shtabet partiake të LSDM-së në shumë qytete të shtetit.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se bëhet fjalë për veprën penale “Dëmtim i objekteve të huaja” e cila ndiqet me padi private në përputhje me nenin 243 të KP-së dhe se po merren masa dhe aktivitete për zbardhjen e ngjarjes

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

31. Është thyer tabela dygjuhëshe e SPIM-it në Ohër (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Të punësuarit në njësinë rajonale të Fondit të Sigurimit të Pensionit dhe Invaliditetit (SPIM) në Ohër kanë vënë re se tabela dygjuhëshe e vendosur në hyrje të ndërtesës është thyer. Sipas informacioneve të transmetuara në media zëdhënësi i SPB-së Ohër ka deklaruar se kanë të dhëna për kryerësin e mundshëm dhe se në koordinim me prokurorin publik po merren masat për zbardhje të ngjarjes.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 28 mars, rreth orës 13:40, Fondi i Sigurimit të Pensionit dhe Invaliditetit, Ohër.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Meta.mk.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së), Shkaktim i urrejtjes, përçarjes apo mostolerancës në bazë të diskriminimit kombëtar, racor, fetar apo në bazë tjetër diskriminimi (Neni 319, KP i RM-së).

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Objekt i cili është qëllim i këtij qëllimi* – në tabelën e cila është thyer janë shkruar informacionet në gjuhën shqipe dhe maqedonase.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nga SPB Ohër janë ndërmarrë menjëherë masat për zbulim të kryerësit për këtë është dërguar lajmërim me shkrim te Prokuroria Themelore Publike Ohër ku janë dhënë të dhëna për kryerësit e mundshëm, për të cilin prokurori publik ka deklaruar se të dyshuarit do të thirren në bisedë në Prokurorinë Themelore Publike Ohër, por deri në momentin e shkrimit të këtij raporti nuk është marrë informacion nëse personat janë thirrur dhe a janë marrë masat, kurse nga Prokuroria Themelore Publike Ohër nuk janë dhënë drejtime dhe detyra për veprim të mëtejshëm.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

32. Është hequr flamuri shtetëror dhe është vendosur ai shqiptar në Kumanovë (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy tinejxherë e kanë hequr nga shtylla flamurin e madh shtetëror të vendosur te shatërvani para ish-hotelit “Kristal” në Kumanovë, kurse në vend të tij kanë vendosur flamur flamurin

shqiptar në gjysmë shtizë. Sipas burimeve të MPB-së të transmetuara në media, bëhet fjalë për dy të rinj të cilët janë kapur menjëherë, ndërkohë është thirrur përforsim i sigurisë me policë, kurse gjatë përpjekjes që ta ulin flamurin ka pasur shtyrje dhe me policinë, ku janë lënduar dy nëpunës të SPB-së Kumanovë. Sipas portalit “Kumanovski muabeti”, dy persona me përkatësi etnike shqiptare me prejardhje nga fshati Sllupčan e kanë ulur flamurin maqedonas dhe janë përpjekur të vendosin flamurin shqiptar në shtyllën në qendër të qytetit. Kjo medie transmeton se sipas dëshmitarëve në vendngjarje ka pasur minimum edhe katër persona të tjerë, por të tjerët kanë ikur në drejtim të panjohur, pas kësaj të dy personat janë arrestuar, kurse në pyetje janë marrë edhe disa dëshmitarë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 31 mars, ora 16:00, Kumanovë.

Burimi i informacioneve: Media elektronike “Kumanovski muabeti”, Media elektronike Pravdiko.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Lëndim trupor (Neni130, KP i RM-së), Shkaktim i urrejtjes, përçarjes apo mostolerancës në bazë të diskriminimit kombëtar, racor, fetar apo në bazë tjetër diskriminimi (Neni 319, KP i RM-së)

Kryerësit: Katër persona.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Objekti i cili është qëllimi i këtij incidenti* – është hequr flamuri shtetëror dhe në vend të tij është vendosur flamuri shqiptar.

Statusi i rastit: Është ngritur fletëparaqitje penale kundër dy personave nga fshati Sllupčan dhe dy personave të panjohur sepse ekziston dyshim i bazuar se lamë kryer vepër penale “shkaktim i urrejtjes kombëtare, racore dhe fetare, përçarje dhe mostolerancë” sipas nenit 319 paragrafi 1, si dhe për kryerjen e veprës penale “sulm mbi një nëpunës zyrtar gjatë kryerjes së obligimeve për sigurinë” sipas nenit 383 paragrafi 1 i KP-së.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se ekzistojnë indikacione të cilat flasin se incidenti është kryer për shkak të përkatësisë etnike të personave të involvuar dhe se më 01.04.2017 SPB Kumanovë te Prokuroria Themelore Publike Kumanovë ka dorëzuar fletëparaqitje penale kundër dy personave nga fshati Sllupčan dhe dy personave të panjohur sepse ekziston dyshim i bazuar se kanë kryer vepër penale “Shkaktim i urrejtjes kombëtare, racore dhe fetare, përçarje dhe mostolerancë” sipas nenit 319 paragrafi 1, si dhe për kryerjen e veprës penale “Sulm mbi një nëpunës zyrtar gjatë kryerjes së obligimeve për sigurinë” sipas nenit 383 paragrafi 1 i KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në shtet.

33. Pesë persona kanë rrahur brutalisht një djalosh nga Studeniçani (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: një person 25-vjeçar nga Studeniçani është sulmuar brutalisht nga disa persona të panjohur. Sulmi ka ndodhur në Jugodrvno në Shkup, ku personi po priste autobus për në Studeniçan. Sipas fjalëve të tij të transmetuara në media, personat të cilët e kanë rrahur kanë qenë tifozë të Vardarit të cilët ishin nisur të festonin fitoren e Vardarit në ligën e kampionëve evropianë në hendboll. Domethënë, nga autobusi numër 5 kanë zbritur disa persona dhe e kanë pyetur se a është shqiptar. Kur e ka thënë po, kanë filluar ta godasin. Një prej personave e ka kapur dhe e ka mbajtur, kurse tjetri e godite, Pastaj ia zhveshën këmbishën dhe me thikë i vizatuan disa kryqe para dhe pas në trup. Personat ishin pesë veta, dhe katër prej tyre e kanë rrahur kurse njëri nuk është afruar. Kanë pasur

maska, shalle me simbolet shtetërore dhe bluza të Vardarit. Pas sulmit kanë ikur drejt sheshit.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 04 qershor, ora 22:00, te Jugodrvro, Shkup.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Alsat-m.

Viktimat e involvuara: Një person.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP i RM-së), Lëndim trupor (Neni 130, KP i RM-së)

Kryerësit: Pesë persona.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - viktimat është sulmuar se ka pohuar se është shqiptar, sulmuesit kanë pasur simbol – flamurin maqedonas.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se SPB Shkup te Prokuroria Themelore Publike Shkup, ka dorëzuar Raport pas marrjes së fletëparaqitjes (KU nr. 5225/17) për veprën penale “Dhunë” sipas nenit 386 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë, si edhe bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

34. Janë demoluar 27 gurrë vari në fshatin Luboten (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Nga kryerës të panjohur janë dëmtuar 27 gurrë vari në varrezat ortodokse në fshatin Luboten. Sipas informacioneve të transmetuara në media, MPB-ja po i zbaton intenzivisht të gjitha aktivitetet operative-teknike dhe në terren të cilat mundësojnë mbledhje dhe analizim të materialit dëshmues, me qëllim që kryerësit e këtij akti të identifikohen dhe kundër tyre të ngrihet procedura penale përkatëse.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 10 korrik, rreth orës 19:30, varrezat ortodokse në fshatin Luboten.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Media elektronike Pozitiv.mk.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimat.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së), Shkaktim i urrejtjes, përçarjes apo mostolerancës në bazë të diskriminimit kombëtar, racor, fetar apo në bazë tjetër diskriminimi (Neni 319, KP i RM-së)

Kryerësit: I panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident me të cilin shkaktohet urrejtje, përçarje dhe mostolerancë nacionale, racore dhe fetare, motiv i njëanshëm është përkatësia fetare, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar janë varrezat ortodokse në fsh. Luboten.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se është përcaktuar se bëhet fjalë për veprën penale “Përdhosje e varrit” sipas nenit 400 të KP-së. Në përgjigje thuhet, gjithashtu, se pas dokumentimit të tërësishëm të ngjarjes, SPB Shkup do të dërgojë te Prokuroria Themelore Publike përkatëse fletëparaqitje përkatëse.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e bashkësive të ndryshme fetare në shtet.

35. Grabitje mbi një pakistanez në fshatin Vaksincë (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Sipas informacioneve të transmetuara në media, një person nga Pakistani, është sulmuar nga tre persona të tjerë nga Pakistani dhe i janë marrë 150 euro. Sipas thënieve të tij, ai ka mbërritur së bashku me një grup personash nga Pakistani në fshatin Vaksincë, ku janë pritur nga tre persona, gjithashtu nga Pakistani (në moshë nga 25-30 vjet) të cilët duhej t'i prisnin dhe dërgonin jashtë vend. Organizatorët e përmendur të gjithë personave u kanë kërkuar nga 2000 euro për person që t'i kalojnë përtej kufirit shtetëror në R. e Serbisë. Meqenëse i dëmtuari nuk kishte të holla, një prej organizatorëve e ka sulmuar, duke e goditur me dy goditje me dorë në fytyrë, ia ka marrë të hollat dhe e kanë lënë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 22 korrik, ora 22:00, fsh. Vaksincë, Kumanovë.

Burimi i informacioneve: Buletini ditore i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Media elektronike Kumanovski muabët.

Viktimat e involvuara: Një person.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP i RM-së), Lëndim trupor (Neni 130, KP i RM-së), Grabitje (Neni 237, KP i RM-së)

Kryerësit: Një person.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident motiv i njëanshëm është statusi i migrantit apo refugjatit, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Model i incidenteve të mëparshme* – ky incident është i fundit në trendin e grabitjes dhe sulmit mbi migrantët.

Statusi i rastit: Nuk është kthyer përgjigje nga MPB-ja.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, MPB-ja nuk i është përgjigjur Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja e ka dërguar në lidhje me këtë incident.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e migrantëve të kalojnë nëpër shtet.

36. Janë sulmuar dhe lënduar romë në pishinë në Veles (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në pishinën e qytetit “Snupi” në Veles janë rrahur disa romë nga Shkupi nga një grup prej dhjetë personash, midis të cilëve ka pasur edhe anëtarë të sigurimit të pishinës, nga agjencia e sigurimit SGS. Një prej shpëtuesve në pishinën “Snupi” në mënyrë arrogante dhe të dhunshme i është drejtuar një prej romëve që u hodh në pishinë me fjalët “Mos më mëso ti mua se kë të lë të hidhet në pishinë, ty nuk të lejohet të hidhesh!” Ndaj këtyre fjalëve kanë reaguar të afërmit e djaloshit, dhe ka ndodhur një grindje e vogël e cila është mbyllur shpejt, pasi ka intervenuar sigurimi – SGS dhe pronari i pishinës. Sipas njërit prej qytetarëve të rrahur, rreth orës 19 kur pothuajse të gjithë vizitorët e pishinës ishin larguar dhe ndërkohë që ata po bëheshin gati për t'u kthyer në Shkup ndërkohë që nipi i tij Ibrahim Umer po dilte nga dhoma e zhveshjes, pa asnjë shkas, një person e ka goditur me shishe qelqi në kokë duke i shkaktuar lëndim trupor të dukshëm – një çarje mbi syrin e djathtë. Personi mandej shton se pas kësaj kanë vrapuar të shohin se çfarë po ndodh, por në atë moment nga jashtë kanë hyrë rreth njëzet persona me veshje civile, me shkopinj dhe shufra hekuri dhe filluan t'i rrahin.

Sipas tij sulmuesit, midis të cilëve përfaqësuesit e sigurimit të pishinës nga SGS-ja, nga shpëtuesi janë thirrur nga pronari. Pas 20 minutash, pasi janë rrahur dhe gjakosur, kanë intervenuar policët të cilët u vunë pranga romëve dhe kanë filluar t'u bërtasin.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 23 korrik, rreth orës 17:00, pishina Snupi, Veles.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Libertas.

Viktimat e involvuara: Dy persona.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP i RM-së), Lëndim trupor (Neni 130, KP i RM-së), Diskriminim racor dhe tjetër (Neni 417, KP i RM-së)

Kryerësit: Një grup prej njëzet personash.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është diskriminimi racor, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Përmbajtja e mesazheve të dhëna* – personit të sulmuar, nuk i është thënë se kërcimi në pishinë ndalohet për të gjithë, por se vetëm atij nuk i lejohet.

2. *Perceptimi i viktimave* – Viktimat e konsiderojnë ngjarjen me motivim të njëanshëm.

Statusi i rastit: Nën hetim/pritet dorëzimi i fletëparaqitjes përkatëse.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nga SPB Veles dhe Prokuroria Themelore Publike po punohet në mbledhjen e të dhënave shtesë në lidhje me ngjarjen dhe sipas tyre nga SPB Veles do të dorëzohet fletëparaqitja përkatëse.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje sigurinë e bashkësive të ndryshme etnike në shtet.

37. Janë thyer dritaret e shtabit të LSDM-së në Shtip (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në rr. "Sremski Front" në Shtip nga kryerës të panjohur janë thyer xhamat e vitrinës së zyrës së partisë politike LSDM. Sipas informacioneve të transmetuara nga mediat, SPB Shtip, ka marrë masat për zbardhjen e tërësishme të ngjarjes.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 28 korrik, ora 10:20, shtabi partiak i LSDM-së në Shtip.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Libertas; TV Star.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (neni 243, KP i RM-së)

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – Lokacioni i synuar është shtabi partiak i LSDM-së.

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidentet në muajt e mëparshëm kur janë dëmtuar shtabe partiake të LSDM-së në shumicën e qyteteve në shtet.

Statusi i rastit: Nuk është kthyer përgjigje nga MPB-ja.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, MPB-ja nuk i është përgjigjur Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja e ka dërguar në lidhje me këtë incident.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

38. Në autobus të NPQ-së është plagosur me thikë një djalosh (e pavërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Rreth orës 19:45 në rr. “Gjorçe Petrov” në Shkup, në autobusin nr. 56 të Ndërmarrjes publike të qarkullimit (NPQ) që qarkullon në linjën drejt fsh. Bojanë, është prishur rendi dhe qetësia publike nga një zënkë midis udhëtarëve në autobus. Pas intervenimit të nëpunësve policorë, në stacionin policor është sjellë R.R. (20) nga fsh. Arnakija, tek i cili është gjetur thikë. Në këtë zënkë është lënduar S.F. (18) i cili ka pasur lëndim të dorës. Është thirrur Ndihma e Shpejtë, e cila pas dhënies së ndihmës mjekësore e ka lëshuar personin në mjekim shtëpiak.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 13 shtator, ora 19:45, autobus i NQP-së nr. 56.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Skopjeinfo.mk

Viktimat e involvuara: Një person.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP), Rrezikim me armë të rrezikshme gjatë zënkës apo rrahjes (Neni 133, KP)

Kryerësit: Një person.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

3. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – incidenti ka ndodhur në një autobus i cili qarkullon nëpër rajone të populluara me banorë me përbërje etnike të përzierë.

4. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik;

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident saktësohet se incidenti ka ndodhur kur autobusi ka lëvizur në rr. “Gjorçe Petrov” në afërsi të stacionit të autobusit tek unaza. Pas daljes në vendngjarje nëpunësit policor të Stacionit policor “Gjorçe Petrov” është arrestuar personi R.R. nga fsh. Arnakija, i cili ka kryer sulm fizik mbi F.S. (18) nga fsh. Lubin, të cilit i ka shkaktuar prerje në dorë me thikë. Për këtë është thirrur ndihma e shpejtë e cila pas dhënies së ndihmës mjekësore e ka lëshuar F.S. në mjekim shtëpiak. Në konsultim me prokurorin publik është miratuar raport me shkelje të konstatuar sipas nenit 12 të Ligjit për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

39. Është gjuajtur me gurë një autobus i NQP-së në Bit-Pazar (E pavërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në bulevardin “Kërste Misirkov” para Poliklinikës “Bit Pazar”, nga rreth dhjetë persona të panjohur me lëndë të fortë është dëmtuar xhami i Ndërmarrjes Publike të Qarkullimit (NDP) i cili ka qarkulluar në linjën nr. 50.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 15 shtator, rreth orës 01:00, bulevardi “Kërste Misirkov”, para Poliklinikës “Bit Pazar”.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Press 24.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP)

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – incidenti ka ndodhur në një autobus i cili qarkullon nëpër rajon të populluar me banorë me përbërje etnike të përzierë; rruga ku është gjuajtur me gurë autobusi

është në një rajon të populluar me banorë me përbërje etnike të përzierë;

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik;

Kryerësit: Grup prej 20 personash meshkuj të panjohur.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se ngjarjen e 15 shtatorit 2017 në Njësinë për Lajmërim dhe Komandë në SPB Shkup e ka paraqitur vetë shoferi i autobusit, D.T. duke pohuar se ajo ka ndodhur rreth orës 00:20. Në përputhje me dëshminë e tij, mbi autobusin është gjuajtur me pllaka begatoni dhe shufra metalike nga rreth 20 persona meshkuj të panjohur dhe janë thyer dy xhama dhe është dëmtuar pjesa e brendshme e autobusit. Nga Njësia për Mbikëqyrje në Vendngjarje është kryer fotografim, kurse nga juristi i NQP-së është dorëzuar procesverbal.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

40. Shtabi i LSDM-së i lyer me jashtëqitje (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një nga shtabet e LSDM-së në Komunën Aerodrom është lyer me jashtëqitje.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 25 shtator, ora 01:45, shtabi partiak i LSDM-së në Komunën Aerodrom.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Lokalno.mk.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

3. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

Statusi i rastit: Nuk është regjistruar.

Përgjigja nga pushtetet lokale: MPB-ja në përgjigjen ndaj Kërkesës për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident thotë se ngjarja e dhënë nuk është paraqitur në Sektorin për Punë të Brendshme Shkup.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

41. Është goditur me gurë shtabi i VMRO-DPMNE-së në Kisella Vodë (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një kryerës i panjohur apo kryerës të panjohur e kanë thyer xhamin e vitrinës së shtabit të VMRO-DPMNE-së në Kisella Vodë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 25 shtator, ora 01:50, shtabi partiak i VMRO-DPMNE-së në Kisella Vodë, Shkup.

Burimi i informacioneve: Televizioni Sitell.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Një kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

Statusi i rastit: Nuk ka përgjigje.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, MPB-ja nuk i është përgjigjur Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën komiteti e ka dërguar në lidhje me këtë incident.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

42. Është thyer shtabi i LSDM-së në Butell (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Është thyer shtabi zgjedhor i LSDM-së në rr. “Butellska” në Komunën Butell. Shtabi ka qenë në funksion në fushatën zgjedhore të Kandidatit për kryetar komune, Velimir Smilevski dhe të listës për këshilltarë së këtij koalicioni.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 26-27 shtator, ora 01:00, shtabi partiak i LSDM-së në Butell, Shkup.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Plusinfo.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE dhe LSDM në më tepër lokacione, përkatësisht komuna në rajonin e qytetit të Shkupit.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Nga përgjigja e marrë nga MPB-ja në lidhje me Kërkesën për informacione publike që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident, del se pas paraqitjes së këtij incidenti nga Njësia e Mbikëqyrjes në Vëndngjarje është kryer fotografim nga nëpunësit policorë të SP “Çair” dhe disa herë është kërkuar nga personat përgjegjës të shtabit të dorëzojnë procesverbal, por ata nuk e kanë dorëzuar atë deri në momenti e dërgimit të kësaj përgjigjeje nga MPB-ja.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

43. Është dëmtuar selia e PDSM në Shkup (e pavërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Është kryer vjedhje e rëndë në hapësirat e Partisë Demokratike të Serbëve në bul. “Koço Racin” në Shkup, që nga byrotë e punës nëpër zyra janë marrë 100.000 denarë, fotoaparati “Nikon”, mansheta për këmisha “Svarovski”, kurse kryerësi pa u vënë re nga askush ka vajtur në drejtim të panjohur.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 27 shtator, ora 09:30, shtabi partiak i PDSM-së në Shkup.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Plusinfo.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Një kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm

është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike
2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE dhe LSDM
3. *Perceptimi i personit të involvuar në këtë ngjarje* – kryetari i PDSM-së, Ivan Stoilkoviq, në deklaratën për mediat tha se bëhet fjalë për përpjekje për presion politik dhe trembje të anëtarëve.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: MPB-ja në përgjigjen ndaj Kërkesës për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident theksohet se më 27 shtator 2017 rreth orës 09:30 është paraqitur se të njëjtën ditë në hapësirat e PDSM-së nga një kryerës i panjohur është kryer vjedhje e rëndë. Pas kësaj, Njësia për Delikte të pronës dhe Delikuencë të të Miturve “Qendër-Bit Pazar” në PTHP Shkup është dorëzuar lajmërim me shkrim nr. 28.13.4-5069 më 11 dhjetor 2017.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

44. Është gjuajtur me gurë shtabi i VMRO-DPMNE-së në Kavadar (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Është thyer me gurë shtabi i VMRO-DPMNE-së në rrugën “Mosha Pijade” në Kavadar..

Data, koha dhe vendi i incidentit: 28 shtator, ora 01:00, shtabi partiak i VMRO-DPMNE-së në Kavadar.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Makfaks.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja(Neni 243, KP).

Kryerësit: Një kryerës i panjohur.

Përshkrimi i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike
2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE, LSDM dhe PDSM.

Statusi i rastit: Është ngritur fletëparaqitje kundërvajtëse për paraqitje të ngjarjes së rreme.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e Kërkesë për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se është vërtetuar se bëhet fjalë për paraqitje të rreme dhe kundër paraqitësit është ngritur fletëparaqitje për kundërvajtje sipas nenit 16 të Ligjit për shkeljet kundër rendit dhe qetësisë publike – Paraqitje e rreme e ngjarjes.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

45. Është thyer shtabi i BESËS në Butell (i vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Nga persona të panjohur është kryer dëmtim i shtabit politik të partisë politike BESA në rr. “Tale Hristov” në qendrën tregtare “Shkup Veri” kështu me një objekt të fortë janë thyer dy xhama të vitrinave dhe janë grisur gjashtë pllakate.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 01 tetor, ora 01:00, shtabi politik i partisë politike BESA në Butell, Shkup.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i MPB-së.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Një kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE, LSDM dhe PDSM.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë nga MPB-ja në lidhje me Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident, thuhet se nga paraqitësi është dorëzuar fletëparaqitje me shkrim për ngjarjen juridike-penale.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

46. Dy djelmosha janë sulmuar në stacion autobusi (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në stacionin e autobusit në bul. “Kërste Misirkov”, dy persona nga fsh. Mirkovci në moshë 19 dhe 20 vjet janë sulmuar fizikisht nga disa persona të panjohur. Pas sulmit sulmuesit e kanë lëshuar vendngjarjen, kurse djelmoshave të lënduar u është dhënë ndihmë mjekësore në Spitalin e përgjithshëm të qytetit “Shën. Naumi i Ohrit” ku së pari u janë konstatuar lëndime trupore.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 01 tetor, ora 17:30, stacioni i autobusit në bul. “Kërste Misirkov”.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Mkd.mk.

Viktimat e involvuara: Dy persona.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP)

Kryerësit: Një grup prej disa personash.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – incidenti ka ndodhur në stacion autobusi në rajon të populluar me banorë me përbërje etnike të përzierë

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik;

Statusi i rastit: I panjohur/ Pritet ngritje e procedurës kundërvajtëse.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Sipas përgjigjes së MPB-së në lidhje me Kërkesën e KMH-së për informacione me karakter publik të dërguar në lidhje me këtë incident, për të njëjtin është bërë procesverbal për pranim të fletëparaqitjes, kurse SPB Shkup po merr masa dhe aktivitete për zbardhjen e prishjes së rendit dhe qetësisë publike, kështu që sipas Ligjit për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike të njësia kompetente për shkelje në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup do të dorëzohet Kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

47. Është thyer shtabi i LSDM-së në fsh. Inxhikovë (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në fsh. Inxhiko, rajoni i Shkupit, një kryerës i panjohur e ka thyer xhamin e derës hyrëse dhe xhamin e vitrinës të shtabit të partisë politike “LSDM”.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 02 tetor, ora 01:00, shtabi partiak i partisë politike të LSDM-së në fsh. Inxhikovë, rajoni i Shkupit.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i MPB-së.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Një kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE, LSDM, PDSM dhe BESA.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë për Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se është marrë procesverbal për pranimin e fletëparaqitjes dhe shënim zyrtar, kurse nga Njësia për Mbikëqyrje në Vendllogje është kryer fotografim.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

48. Është lënduar kryetari i komunës Shuto Orizari, Elvis Bajram (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Elvis Bajram, i cili në momentin e ngjarjes ka qenë kryetar aktual i komunës së Shuto Orizari, si edhe kandidat për kryetar i koalicionit të udhëhequr të VMRO-DPMNE-së në zgjedhjet lokale, është lënduar në një zënkë midis dy grupeve në Shuto Orizari. Bajram pas zënkës është sjellë në spitalin “8 Shtatori” dhe i është konstatuar lëndimi në kokë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 02 tetor, ora 19:00, Shuto Orizari.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Evropa e Lirë.

Viktimat e involvuara: Një person – Kryetari i Komunës së Shuto Orizarit.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP)

Kryerësit: Një grup prej disa personash.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Koha kur ka ndodhur në incidenti* – sulmi ka ndodhur gjatë prezantimit të fushatës zgjedhore.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë për Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se janë dorëzuar tetë procesverbale për shkeljen e konstatuar sipas nenit 11 alineja 2 e Ligjit për Kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo .

49. Është dëmtuar shtabi i VMRO-DPMNE-së në Manastir (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në Manastir, në rr. “Cërveni Steni” është thyer xhami i derës hyrëse e zyrës vendore të partisë politike të VMRO-DPMNE-së.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 02 tetor, ora 20:30, shtabi partiak i partisë politike të VMRO-DPMNE-së në Manastir.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Shetalishte.mk.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

2. *Model i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE, LSDM, PDSM dhe BESA.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë për Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se bëhet fjalë për veprën penale “Dëmtim i objekteve të huaja” që ndiqet me padi private, si dhe se SPB Manastir po punon në zbardhjen e ngjarjes dhe zbulimin e kryerësve.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

50. Është dëmtuar shtabi i BDI-së në Shkup (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një kryerës i panjohur ka thyer dy xhama dritarësh në shtabin e partisë politike BDI, në rrugën “Tale Hristov” në Shkup-Veri.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 03 tetor, ora 15:00, shtabi partiak i partisë politike BDI në Shkup-Veri.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Press24.mk.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Një kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

2. *Model i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE, LSDM, PDSM dhe BESA.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë për Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se është mbajtur procesverbal për pranim të fletëparaqitjes së ngjarjes dhe shënim zyrtar, kurse nga Njësia për Mbikëqyrje në Vendlindje është kryer përpunim krim-teknik.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

51. Është thyer shtabi i “Obedineti za Makedonija” në Draçevë (vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një kryerës i panjohur e ka dëmtuar me gurë shtabin e partisë politike OM në rr. “Zhivko Firfov” në lagjen Draçevë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 07 tetor, ora 23:00, shtabi partiak i partisë politike OM në Draçevë.

Burimi i informacioneve: TV Nova.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Një kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE, LSDM, PDSM, BESA dhe BDI.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: MPB në përgjigjen e dërguar për Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident, thotë se është mbajtur procesverbal për praninë të fletëparaqitjes së ngjarjes dhe shënim zyrtar, kurse nga Njësia për Informim dhe Komandë në SPB Shkup, ku është paraqitur ngjarja në vendngjarje ka kryer fotografim.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

52. Janë thyer xhamat e shtabit të VMRO-DPMNE-së në fsh. Drugovo, Kërçovë (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një kryerës i panjohur me objekt të fortë ka thyer dy xhama të objektit i cili përdoret si shtab i partisë politike VMRO-DPMNE .

Data, koha dhe vendi i incidentit: 09 tetor, ora 01:00, shtabi partiak i partisë politike VMRO-DPMNE në fsh. Drugovo, Kërçovë.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Točka.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Një kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

2. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE, LSDM, PDSM, BESA dhe BDI.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Sipas përgjigjes së dorëzuar nga MPB në lidhje me Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia dërgoi MPB-së, ky incident është paraqitur nga një qytetar i fshatit Drugovo, kurse pas këtij rasti MPB po ndërmerr masat dhe aktivitetet për zbardhje të rastit dhe gjetje të kryerësve dhe më pas është dorëzuar Lajmërim te pala e dëmtuar.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

53. Një i mitur është rrahur mizorisht në autobus të NQP-së (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në Shkup, në rrugën Alija Avdoviq" në autobusin nr. 65 që qarkullon nga lagjja Çento në drejtim të fshatit Stajkovci ka ndodhur një rrahje.

Në stacionin e autobusit te Shkolla Fillore “25 maji”, një grup prej rreth dhjetë të miturish, kanë shtyrë në autobus një djalosh 17-vjeçar nga fshati Smilkovci, nxënës në vitin e katërt në ASUC dhe e kanë sulmuar fizikisht duke e goditur me grushte dhe shqelma në pjesën e kokës dhe trupit. Në një moment një prej sulmuesve e ka goditur me objekt të fortë në kokë, pastaj grupi është shpërndarë. Me automjetin e ndihmës së shpejtë djaloshi është dërguar në Spitalin e përgjithshëm të qytetit “Shën. Naum i Ohrit” ku i është dhënë ndihma e parë, dhe më pas është lëshuar në mjekim shtëpiak.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 10 tetor, ora 19:00, autobus i NQP-së nr. 65.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Republika.mk.

Viktimat e involvuara: Një person i mitur.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP), Rrezikim me mjet të rrezikshëm gjatë zënkës apo rrahjes (Neni 133, KP)

Kryerësit: Një grup prej dhjetë të miturish.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – Incidenti ka ndodhur në një autobus i cili qarkullon nëpër rajone të populluara me njerëz me përbërje etnike të ndryshme, është e mundshme prejardhja etike e kryerësve të jetë e ndryshme nga ajo e viktimës.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik;

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë nga MPB-ja për Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nga SPB Shkup te PTHP Shkup është dërguar Informim për veprën penale „Dhunë“ sipas nenit 386 KP (KU. nr. 10002/17).

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

54. Është dëmtuar shtabi i partisë politike GROM në fsh. Bardovci (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Shtabi zgjedhor i partisë politike GROM në fshatin Bardovci, Shkup, është dëmtuar kur një person i pa njohur ka hedhur një objekt të fortë duke e thyer kështu xhamin e vitrinës.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 10 tetor, ora 20:15, Shtabi partiak i partisë politike GROM në fsh. Bardovci.

Burimi i informacioneve: Fokus.mk.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktimë.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Një kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

2. *Model i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE, LSDM, PDSM, BESA dhe BDI.

Statusi i rastit: I mbyllur, i paraqituri nuk kishte interes që të dorëzojë fletëparaqitje për incidentin.

Përgjigja nga pushtetet lokale: MPB-ja i dha përgjigje Kërkesë për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar për këtë incident, me të cilin vërtetohet se incidenti ka ndodhur me gjuajtje guri nga një person i panjohur në drejtim të shtabit zgjedhor të partisë GROM, kurse menjëherë pas paraqitjes së ngjarjes nëpunësit policorë të SP “Karposh” kanë dalë në vendngjarje, por në telefon me

të paraqiturin, nga ana e këtij është theksuar se nuk dëshiron dhe nuk do të dorëzojë procesverbal për praninë të fletëparaqitjes për dëmin e kryer.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

55. Gjuajtje me armë në shtabin e BDI-së (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në fsh. Plasnicë gjatë mbajtjes së mitingut publik në organizim të partisë BDI, përkatësisht në kolonën e formuar nga mjetet që ka lëvizur nga fshati Lisiçani nëpër fsh, Pregellovë drejt fsh. Plasnicë, kur kanë arritur në afërsi të shtabit të BDI-së, që gjendet në mes të fshatit, nga kolona e automjeteve në lëvizje janë gjuajtur disa plumba me armë zjarri, ndoshta pistoletë. Të njëjtën mbrëmje rreth orës 20.00 në fsh. Lisiçani, ndërsa mbahej mitingu publik ku ka folur kryetari i komunës së fsh. Plasnicë, një person i panjohur ka gjuajtur disa herë me armë zjarri.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 12 tetor, ora 20:50, shtabi partiak i partisë politike BDI në fsh. Plasnicë.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i MPB-së.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP), Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm (Neni 288, KP)

Kryerësit: Një kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike
2. *Koha e ndodhjes së incidentit* – pak kohë para gjuajtjes me armë në shtabin e partisë politike BDI, është mbajtur mitin ku ka folur kryetari i komunës së fsh. Plasnicë, gjatë këtij mitingu një person i panjohur ka gjuajtur disa herë me armë zjarri.
3. *Modeli i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE, LSDM, PDSM, BESA dhe BDI.

Statusi i rastit: Nuk është regjistruar.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë nga MPB-ja për Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se një rast i tillë nuk është evidentuar në evidencat të cilat i mban Ministria.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

56. Është thyer xhami i shtabit të VMRO-DPMNE-së në Kavadar (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në rrugën “Ilindenska” në Kavadar një person i panjohur e ka thyer xhamin e objektit të cilin e ka përdorur koalicioni i udhëhequr nga partia politike VMRO-DPMNE.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 13 tetor, ora 00:30, shtabi partiak i VMRO-DPMNE-së në Kavadar.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Vesti.mk.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Një kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm

është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

2. *Model i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE, LSDM, PDSM, BESA, BDI dhe GROM.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë nga MPB-ja për Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident, thuhet se nuk është dorëzuar material zyrtar te PTHP Kavadar sepse nuk është përcaktuar ende identiteti i kryerësit të ngjarjes së paraqitur.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në shtet.

57. Është dëmtuar shtab i VMRO-DPMNE-së në Shkup (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një kryerës i panjohur ka kryer dëmtim me gurë, përkatësisht e ka thyer xhamin e shtabit të VMRO-DPMNE-së, që gjendet në rrugën “Cvetan Dimov”.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 14 tetor, ora 00:30, shtabi partiak i VMRO DPMNE-së në Çair, Shkup.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Netpres.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Një kryerës i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

2. *Model i incidenteve të mëparshme* – këtij incidenti i paraprijnë incidente nga ditët e mëparshme, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE, LSDM, PDSM, BESA, BDI dhe GROM.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e marrë nga MPB-ja për Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident, nuk jepen më tepër detaje në lidhje me masat dhe aktivitetet e marra për zbardhjen e rastit.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

58. Dhunë para shtabit të GROM në Shkup (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në Shkup në rr. “Mitropolit Teodosij Golloganov” automjet motorik udhëtarësh i markës mercedez me tabela të Shkupit, ka ndaluar para shtabit të partisë politike GROM ku ishin mbledhur rreth 100 qytetarë, dhe nga automjeti ka dalë S.R. i cili ka nxjerrë thikë dhe pranga, dhe pastaj i ka kërcënuar qytetarët e pranishëm dhe pastaj është larguar me automobil.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 15 tetor, ora 22:00, shtabi partiak i GROM-it në Shkup.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i MPB-së.

Viktimat e involvuara: Më tepër aktivistë të partisë politike GROM.

Lloji i krimeve: Rrezikim i sigurisë (Neni 144, KP), Rrezikim me mjet të rrezikshëm gjatë zënkës apo rrahjes (Neni 133, KP)

Kryerësit: Një person.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

2. *Perceptimi i personit të involvuar në këtë incident* – Në deklaratën për mediat, kryetari i partisë politike GROM, Stevço Jakimovski, tha se partia politike LSDM ka dërguar kriminelë të nëntokës me qëllim që t'i sulmojnë aktivistët e GROM-it.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përputhje me përgjigjen e marrë nga MPB-ja në lidhje me Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident, thuhet se nëpunësit policorë të SPB Shkup kanë dalë në vendngjarje, ku kanë konstatuar se automjeti mercedez me tabela të Shkupit ka ndaluar para shtabit të GROM-it, prej tij kanë dalë personat S.R. dhe E.Sh. të cilët kanë filluar të shajnë, të kërcënohen dhe të ofendojnë qytetarët e pranishëm, simpatizuesit të partisë politike. Në drejtim të zbardhjes së kësaj ngjarjeje, është kryer bisedim me tre persona, pastaj në bisedim janë thirrur edhe S.R. dhe E.Sh., kurse në lidhje me ngjarjen është informuar edhe Prokurori publik dezurn i cili ka dhënë drejtime që të kryhet bisedim me personat e thirrur, si dhe të sigurohen edhe personat e tjerë dhe dëshmi për ngjarjen, kurse materialin e përgjithshëm me Informim do t'i dorëzohet PTHP. Nga Njësia për Krime të Dhunshme në SPB Shkup te PTHP Shkup është dërguar Letër informimi nr. 28.11.2/02-616 më 18.10.2017.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

59. Janë lënduar shumë persona gjatë festimit të fitores në Sveti Nikollë (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Janë lënduar më tepër persona në Sveti Nikollë kur nëpunësi policor i Stacionit policor Sveti Nikollë, i cili nuk ka qenë i angazhuar me punë dhe një grup qytetarësh e kanë prishur rendin dhe qetësinë publike gjatë festimit të fitores së kandidatit për kryetar komune për Sveti Nikollën. Janë lënduar më tepër persona dhe atyre u është dhënë ndihmë në Shtëpinë e shëndetit në Sveti Nikollë.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 16 tetor, ora 00:10, qendra e Sveti Nikollës.

Burimi i informacioneve: Botimi elektronik i gazetës “Nova Makedonija”.

Viktimat e involvuara: Grup personash.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP)

Kryerësit: Një person.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Koha e ndodhjes së incidentit* – ngjarja ka ndodhur gjatë festimit të fitores së kandidatit për kryetar komune për Sveti Nikollën në sheshin në Sv. Nikollë

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: MPB-ja në përgjigjen e dhënë në lidhje me Kërkesën për informacione me karakter publik të dërguar nga KMH-ja për këtë ngjarje e ka vërtetuar incidentin, duke theksuar se pas autorizimit të prokurorit publik është kryer mbikëqyrje në vendngjarje, janë kryer biseda me personat e involvuar, janë mbledhur dëshmi nga dëshmitarët dhe është siguruar dokumentacioni mjekësor nga personat që punojnë në Shtëpinë e Shëndetit në Sveti Nikollë. Informacionet e mbledhura së bashku me shënimin e përgatitur zyrtar janë dorëzuar në PTHP Sveti Nikollë, e cila po

punon në zbardhjen e ngjarjes, kurse dokumentacioni i tërësishëm mbi masat e marra është dorëzuar edhe në Sektorin për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale – Njësia Shtip.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

60. Janë sulmuar të mitur te Qendra e transportit në Shkup (e pavërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Persona të mitur janë sulmuar në stacionin e autobusit, nën Stacionin hekurudhor, përkatësisht në Qendrën e transportit në Shkup. Tre peronave të mitur, dy prej të cilëve në moshë 16-vjeçare dhe njëri në moshë 15-vjeçare, ndërkohë që prisnin autobusin, u është ofruar një grup më i madh prej 10-15 personash në moshë nga 15 deri në 17 vjet, dhe njëri prej tyre ka nisur të godasë një prej të miturve në kokë. Pastaj është sulmuar edhe i mituri tjetër, pastaj sulmuesit kanë ikur në drejtim të panjohur.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 19 tetor, ora 12:15, stacioni i autobusit në bul. “Kërste Misirkov” .

Burimi i informacioneve: Media elektronike Libertas.

Viktimat e involvuara: Tre persona të mitur.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP)

Kryerësit: Grup prej disa personash të mitur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – incidenti ka ndodhur në një stacion autobusi ku qarkullojnë njerëz me përbërje etnike të përzierë, ekziston mundësia që prejardhja etnike e Kryerësve të jetë e ndryshme nga ajo e viktimave.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik;

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: MPB-ja në përgjigjen e dhënë në lidhje me Kërkesën për informacione me karakter publik të dërguar nga KMH-ja për këtë ngjarje e ka vërtetuar incidentin, duke theksuar se nga SPB Shkup te PTHP Shkup ka dorëzuar Informim me shkrim nr. 28.11.2/02-646 më 27 tetor 2017.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

61. Dhunë në Sv. Nikollë (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një polic nga Sveti Nikollë ka sulmuar dhe ka lënduar një çift të martuar. Sipas dëshmimeve të bashkëshortit, polici pa asnjë shkak ia ka thyer xhamin e automjetit dhe ka filluar ta godasë me shqelma dhe grushte, kurse pastaj e ka zënë për qafe bashkëshorten e tij, e cila ishte ulur afër tij. Ngjarja ka ndodhur në mesnatë pas festimit të fitores së LSDM-së në Sveti Nikollë, kurse çifti ka qëndruar në rrugëkryq. Çifti i martuar janë aktivistë të LSDM-së. Sipas të dhënave të policit, përndryshe simpatizues i VMRO-DPMNE-së, çifti e ka provokuar dhe se ai ka qenë sulmuar më parë nga qindra aktivistë të LSDM-së, të cilët kanë ardhur para ndërtesës së tij, e kanë thërritur të zbresë dhe ia kanë dëmtuar automobilin. Janë përpjekur t'i futen në banesë dhe atëherë ai ka dalë të shikojë se çfarë ka ndodhur. Në përputhje me dëshmitë e policit, ai ka qenë qëllimi i sulmit, sepse në heshtjen para zgjedhjeve ai ka ndaluar aktivistët e LSDM-së të shpërndajnë materiale zgjedhore.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 19 tetor, ora 20:40, Sv. Nikollë.

Burimi i informacioneve: Gazeta elektronike 24lajme.

Viktimat e involvuara: Çift i martuar.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP)

Kryerësit: Një person.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Koha e ndodhjes së incidentit* – ngjarja ka ndodhur menjëherë pas fitores në zgjedhjet lokale të kandidatit për kryetar komune të Sv. Nikollës në sheshin në Sv. Nikollë.

Statusi i rastit: Nën hetim.

Përgjigja nga pushtetet lokale: MPB-ja në përgjigjen e dhënë në lidhje me Kërkesën për informacione me karakter publik të dërguar nga KMH-ja për këtë ngjarje e ka vërtetuar incidentin, duke dëshmuar se ai lidhet me ngjarjen e regjistruar me nr. 59 në këtë Aneks. Njëkohësisht, MPB, lajmëroi se dokumentacioni i tërësishëm zyrtar i është dorëzuar PTHP Sveti Nikollë, por deri në momentin e dërgimit të përgjigjes MPB-ja nuk është informuar për rezultatin e masave të marra dhe për kualifikimin juridik të veprës.

62. Është sulmuar një i mitur pesëmbëdhjetëvjeçar në autobus (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një i mitur pesëmbëdhjetëvjeçar nga fshati Nikishtani, Shkup, nxënës në Shkollën e mesme “Cvetan Dimov” në autobusin me numër 22 është sulmuar nga 7-8 nxënës, dhe ka marrë lëndime në trup dhe kokë. Nga mjeku në Spitalin e përgjithshëm të qytetit “Shën Naumi i Ohrit” i janë konstatuar lëndimet trupore dhe ai është lëshuar në mjekim shtëpiak.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 25 tetor, ora 19:00, autobusi i NQP-së nr. 22 i cili në atë moment gjendej në bul. “Partiyanski odredi”

Burimi i informacioneve: Media elektronike 24vesti.

Viktimat e involvuara: Një person i mitur.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP)

Kryerësit: Një grup prej 7-8 personash meshkuj.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – Incidenti ka ndodhur në autobus i cili qarkullon në rajone të populluara me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Sipas përgjigjes së marrë nga MBP-ja në lidhje me Kërkesën për informacione me karakter publik që MKH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident, thuhet se nga biseda e kryer me të miturin e lënduar është mësuar se ndërsa ai ka udhëtuar me autobusin e NQP-së nr. 22 në stacionin e autobusit të Katedralja në Shkup kanë hipur 7-8 persona meshkuj në moshë 17-18 vjeçare të cilët e kanë sulmuar duke i shkaktuar lëndime trupore në kokë dhe trup, pastaj kanë zbritur nga autobusi dhe kanë ikur në drejtim të panjohur. Nga SPB Shkup të PTHP Shkup është dorëzuar Informim me shkrim në lidhje me veprën penale „Dhunë“ sipas nenit 386 KP (KU. nr. 10538/17).

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

63. Është sulmuar një i mitur në autobusin nr. 81 të NQP-së (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një djalosh pesëmbëdhjetëvjeçar është lënduar me shufër metalike nga disa persona të cilët hipën në stacionin në fshatin Brazda, rajoni i Shkupit. Në stacionin e autobusit në fshatin Brazda, në autobus kanë hipur 12 persona dhe para se të zbresin nga autobusi në stacionin tjetër, kanë goditur, ndoshta me shufër metalike, në pjesën e këmbës një të mitur 15-vjeçar nga fshati Brazda. Djaloshi me automjet privat është dërguar në Spitalin e përgjithshëm të qytetit ku i janë konstatuar lëndime trupore dhe është lëshuar në mjekim shtëpiak.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 03 nëntor, ora 21:00, autobus i NQP-së nr. 81

Burimi i informacioneve: Media elektronike Libertas.

Viktimat e involvuara: Një person i mitur.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP)

Kryerësit: Grup prej dymbëdhjetë personash.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – Incidenti ka ndodhur në autobus i cili qarkullon në rajone të populluara me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik;

Statusi i rastit: Është ngritur fletëparaqitje penale për veprën penale „Dhunë“ (Neni 386 KP).

Përgjigja nga pushtetet lokale: Sipas përgjigjes së marrë nga MPB-ja në lidhje me Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident, nga SPB Shkup te PTHP Shkup është dorëzuar fletëparaqitje penale me KU. Nr. 717/18 kundër tre personave sepse ekzistojnë baza dyshimi për kryerjen e veprës penale „Dhunë“ sipas nenit 386 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

64. Dy djelmossa janë sulmuar në stacion autobusi (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në stacionin e autobusit në rr. “Bosnja dhe Hercegovina” një person nëntëmbëdhjetëvjeçar është sulmuar fizikisht nga më tepër persona të panjohur. Ata e kanë goditur me gurë në pjesën e fytyrës duke marrë kështu një plagë të dukshme.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 12 nëntor, ora 00:00, stacioni i autobusit në rr. “Bosnja dhe Hercegovina”.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i MPB-së.

Viktimat e involvuara: Një person.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP)

Kryerësit: Grup prej 4-5 personash të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – Incidenti ka ndodhur në stacion autobusi në rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: Nën hetim/ Pritet ngritja e procedurës kundërvajtëse.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e saj në lidhje me Kërkesën për informacione me karakter publik që MPB-ja ia ka dërguar KMH-së në lidhje me këtë incident precizohet se personi

është sulmuar rreth orës 21:00 nga 4-5 persona të panjohur, të cilët nga një anë e kanë goditur me gur në pjesën e fytyrës. Në lidhje me këtë ngjarje, është marrë procesverbal për pranimin e fletëparaqitjes dhe janë dorëzuar dy shënime zyrtare, kurse SPB Shkup po merr masa dhe aktivitete për zbardhjen e prishjes së rendit dhe qetësisë publike, mandej në përputhje me Ligjin për Kundërvajtje kundër Rendit dhe Qetësisë Publike, te njësia kompetente për shkelje në Gjykatën Themelore Shkup 1 do të dorëzohet kërkesë për zbatimin e procedurës kundërvajtëse.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

65. Një person është shpuar me thikë në kejin në Shkup (e pavërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në rr. “Kej 13 Nëntori” një person D.M. (22) nga fshati Trubarevo, është sulmuar nga dy persona të panjohur, kurse njëri prej tyre ka përdorur thikë me të cilën e ka shpuar. Personi është dërguar në Spitalin e përgjithshëm të qytetit “Shën Naumi i Ohrit” – Shkup, ku nga mjeku i janë konstatuar lëndime trupore.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 19 nëntor, ora 16:30, rr. “Kej 13 Nëntori”.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i MPB-së.

Viktimat e involvuara: Një person.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP)

Kryerësit: Dy persona.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* - gjatë viteve të mëparshme, në afërsi të kejit dhe parkut të qytetit shumë herë kanë ndodhur incidente të motivuara etnikisht.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik;

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik të cilën ia ka dërguar KMH-ja, MPB-ja thotë se më 19 nëntor 2017 nga ekipi i Ndihmës së shpejtë është paraqitur me telefon se një person 22-vjeçar me plagë të shpuar me objekt të mprehtë në pjesën e kraharorit dhe me plagë të dukshme në kokë është gjetur pas objektit të Qeverisë së RM-së. Pas bisedës së kryer me personin e lënduar u mësua se ai është sulmuar nga dy persona të panjohur në lokacionin e dhënë më sipër, më pas është mbajtur procesverbal për pranim të fletëparaqitjes dhe janë dorëzuar dy shënime zyrtare.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

66. Janë sulmuar dy persona në kejin e Lumit Vardar (e pavërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Në Shkup në kejin e Lumit Vardar, dy persona janë sulmuar fizikisht nga një grup më i madh personash të veshur me dukserë dhe kapele të cilët pas sulmit e kanë lëshuar vendngjarjen. Personat e lënduar me automjetin e Ndihmës së shpejtë mjekësore janë dërguar në Spitalin e përgjithshëm të qytetit “Shën. Naumi i Ohrit”, ku është përcaktuar se ata kanë marrë lëndime trupore dhe pas dhënies së ndihmës mjekësore janë lëshuar në mjekim shtëpiak.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 19 nëntori, ora 20:30, rr. “Kej 13 Nëntori”.

Burimi i informacioneve: Buletini ditor i MPB-së.

Viktimat e involvuara: Dy persona.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP)

Kryerësit: Një grup prej 10-12 personash të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* - gjatë viteve të mëparshme, në afërsi të kejit dhe parkut të qytetit shumë herë kanë ndodhur incidente të motivuara etnikisht.

2. *Model i incidenteve të mëparshme* – të njëjtën ditë, disa orë më parë një person është shpuar me thikë në kejin e Vardarit.

3. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik;

Statusi i rastit: Ngjarja është kualifikuar si prishje e rendit dhe qetësisë publike me sulm fizik.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e dorëzuar në lidhje me Kërkesën për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar në lidhje me këtë incident, MPB-ja e vërteton ngjarjen e lartpërmendur, dhe thotë se dy viktimat në këtë ngjarje kanë qenë në moshë 18 dhe 19-vjeçare dhe ata kanë marrë lëndime të dukshme dhe prerje në kokë. Nga biseda e kryer me personat e dëmtuar janë marrë njohuri se ata në afërsi të QIK-ut janë sulmuar fizikisht nga 10-12 persona të panjohur, në moshë rreth 20-23 vjet të veshur me dukserë dhe kapele në kokë. Pas konsultimit të kryer me Prokurorin publik ngjarja është kualifikuar si prishje e rendit dhe qetësisë publike me sulm fizik, kundërvajtje e paraparë me neni 12 të Ligjit për Kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

67. Një i mitur është rrahur në rrugë në Shkup (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Një djalosh 16-vjeçar është sulmuar fizikisht nga 5-6 persona të panjohur në moshë nga 16-20 vjet. Sulmuesit i kanë goditur me grushte dhe shqelma në pjesën e trupit dhe të kokës, ndërsa më pas kanë ikur nga vendngjarja.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 25 nëntor, ora 21:30, rr. "Metodija Andonov-Çento"

Burimi i informacioneve: Media elektronike MKD.mk.

Viktimat e involvuara: Një person i mitur.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP)

Kryerësit: Një grup prej 5-6 personash.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – Ngjarja ka ndodhur në një rajon të populluar me njerëz me përbërje të përzierë etnike, ka mundësi që prejardhja etnike e kryerësve të jetë e ndryshme nga ajo e viktimës.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik;

Statusi i rastit: Nën hetim/ Pritet të ngrihet procedurë kundërvajtëse.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Pas Kërkesës së dorëzuar për informacione me karakter publik, të cilën KMH-ja e ka dërguar në lidhje me këtë incident, MPB-ja ka dërguar Përgjigje për Kërkesë ku thuhet se nga udhëheqësi i turnit është mbajtur procesverbal për pranim të fletëparaqitjes dhe janë dërguar pesë shënime zyrtare për informacione e marra nga qytetari. Njëkohësisht, në këtë përgjigje theksohet se SPB Shkup po ndërmerr masa dhe aktivitete për zbardhjen e prishjes së rendit dhe

qetësisë publike, kështu që në përputhje me Ligjin për Kundërvajtje kundër Rendit dhe Qetësisë Publike, te njësia kompetente për shkelje në Gjykatën Themelore Shkup 1 do të dorëzohet Kërkesë për zbatimin e procedurës kundërvajtëse

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

68. Janë thyer hapësirat partiake të VMRO-DPMNE-së në Ohër (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Hapësirat e komitetit të komunal të VMRO-DPMNE-së në Ohër janë thyer. Përveç dy dritareve të thyera nëpërmjet të cilave personat janë futur në këto hapësira, nuk ka dëmtime të inventarit në komitet.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 10 dhjetor, rreth orës 00:00, shtabi partiak i VMRO-DPMNE-së në Ohër.

Burimi i informacioneve: Skopjeinfo.mk.

Viktimat e involvuara: Përveç dëmit material, në këtë incident nuk ka viktima.

Lloji i krimeve: Dëmtim i objekteve të huaja (Neni 243, KP).

Kryerësit: Një kryer i panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është përkatësia politike apo bindja politike, kurse indikatorë të njëanshëm janë:

1. *Lokacioni i synuar* – lokacioni i synuar është shtabi i një partie politike

2. *Model i incidenteve të mëparshme* – këtë incidenti i paraprijnë incidente nga periudha e fushatës parazgjedhore dhe procesit zgjedhor, kur janë dëmtuar shtabet e partive politike VMRO-DPMNE, LSDM, PDSM, BESA, BDI dhe GROM..

Statusi i rastit: Është ngritur fletëparaqitje penale kundër një kryerësi të panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e kërkesës për informacione me karakter publik, që KMH-ja ia dërgoi MPB-së në lidhje me këtë incident, shkruhet se Sektori për Punë të Brendshme Ohër ka dorëzuar te Prokuroria Themelore Ohër ka dorëzuar fletëparaqitje penale kundër një personi të panjohur sepse ekzistojnë baza dyshimi për veprën penale të kryer “Vjedhje e rëndë”, kurse në lidhje me nenin 236 paragrafi 1 n.l. nenin 19 të KP-së, si dhe se Sektori i Punëve të Brendshme Ohër po vazhdon me aktivitetet zyrtare për realizim të tërësishëm dhe zbulim të kryerësve.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident ka implikime negative financiare për partinë politike dhe shkakton shqetësim për sigurinë në bashkësitë ku vepron ajo.

69. Është sulmuar fizikisht një i mitur në autobus të NQP-së (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Më tepër persona të panjohur në moshë nga 15 deri në 18 vjet kanë sulmuar fizikisht një djalosh 15-vjeçar në autobusin e NQP-së nr. 65 i cili qarkullonte nga fshati Stajkovci drejt Qendrës së transportit-Shkup. Në fshatin Singeliq, në autobus kanë hyrë më tepër persona të panjohur të cilët pasi janë ngjitur në katin e sipërm, së pari e kanë sulmuar të mitur, kurse mandej edhe shokët e tij.

Djaloshi ka marrë lëndime dhe në Spitalin e përgjithshëm të qytetit “Shën Naumi i Ohrit” i është dhënë ndihmë mjekësore.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 15 dhjetor, ora 13:20, autobus i NQP-së nr. 65.

Burimi i informacioneve: Media elektronike Vesti.mk.

Viktimat e involvuara: Një person i mitur.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP).

Kryerësit: Grup prej më tepër personash të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – Incidenti ka ndodhur në autobus i cili qarkullon në rajone të populluara me njerëz me përbërje të përzierë etnike

2. *Model i incidenteve të mëparshme* – ky incident është edhe një incident tjetër nga seria e sulmeve në autobusin e NQP-së nr. 65

3. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik;

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nga Sektori i Punëve të Brendshme Shkup te Prokuroria Themelore Publike Shkup është dërguar Informim me shkrim në lidhje me veprën penale „Dhunë“, të paraparë dhe e dënueshme sipas nenit 386 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.

70. Janë rrahur të mitur në Butel (e vërtetuar)

Çfarë ka ndodhur: Dy persona të mitur janë sulmuar fizikisht nga një numër më i madh personash meshkujsh në moshë nga 16-18 vjet në rrugën “Bosnja dhe Hercegovina” në Butell, Shkup. Njërit prej të miturve i është shkakuar lëndim objekt të fortë në pjesën e shpatullës së majtë, ndoshta me thikë, dhe më pas i është dhënë ndihmë mjekësore në Qendrën e urgjencës “Nënë Tereza”. Siç thonë, sulmi fizik ka ndodhur pasi më parë shoku i të miturit të sulmuar është zënë me sulmuesit në oborrin e shkollës “Zef Lush Marku”.

Data, koha dhe vendi i incidentit: 18 dhjetor, ora 21:00, rr. “Bosnja dhe Hercegovina”

Burimi i informacioneve: Media elektronike Skopjeinfo.mk.

Viktimat e involvuara: Dy persona të mitur.

Lloji i krimeve: Dhunë (Neni 386, KP), Lëndim trupor (Neni 130, KP)

Kryerësit: Një grup prej më tepër personash.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të njëanshëm: Në këtë incident, motivi i njëanshëm është prejardhja etnike, shtetësia ose gjuha, kurse indikatorët e njëanshëm janë:

1. *Dallimi i supozuar në prejardhjen etnike* – ngjarja ka ndodhur në rajon të populluar me njerëz përbërje etnike të përzierë; ka mundësi që prejardhja etnie e kryerësve të jetë e ndryshme nga ajo e viktimës.

2. *Natyra e dhunës* – incidenti ka ndodhur në publik.

Statusi i rastit: I panjohur.

Përgjigja nga pushtetet lokale: Në përgjigjen e Kërkesës për informacione me karakter publik që KMH-ja ia ka dërguar MPB-së në lidhje me këtë incident thuhet se nga Sektori i Punëve të Brendshme Shkup te Prokuroria Themelore Publike Shkup është dërguar Informim me shkrim në lidhje me veprën penale „Dhunë“, të paraparë dhe e dënueshme sipas nenit 386 të KP-së.

Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë: Ky incident e vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha etnike në shtet.